RAPORTI PËRFUNDIMTAR
MBI

"AUDITIMIN FINANCIAR"

BASHKIA HIMARË

Tiranë, tetor 2026

	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	2-6
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	2-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-6
II.	**HYRJA**	6-10
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Identifikimi i çështjes	6
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6-7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7
5	Kriteret e Vlerësimit	7-8
6	Standartet e auditimit	8
7	Metodat e auditimit	8-10
8	Dokumentimi i auditimit	10
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	10-82
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10-11
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11
	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.	11-19
	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	19-28
	Mbi auditimin e te ardhurave vendore	28-48
	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2025	48-61
	Mbi zbatimin e rekomandimeve te lena	61-79
IV.	**REKOMANDIME**	79-90

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar me objekt vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Himarë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2025. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Himarë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Bashkia Himarë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij. Auditimi të Bashkisë Himarë për periudhën e aktivitetit financiar të vitit 2023-2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Himarë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Himarë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
-Auditim mbi burimin e krijimit të ardhurave.
-Auditim mbi kontabilitetin dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025.
-Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të

audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit, në kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 21,693 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.
Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni Bashkia Himarë, për periudhën nën auditim paraqet të meta në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka **konstatuar 16** gjetje, nga të cilat;
-15 Masa organizative;
-1 Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, të ardhura të munguara 314,808,552 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.
- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se detyrimet për taksa dhe tarifa vendore, në fund të vitit 2025 janë në vlerën 314,808,552 lekë, të cilat përbëhen nga:
-Detyrimet që subjektet fizik/juridik kanë ndaj Bashkisë Himarë për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 janë në vlerën 171,283,112 lekë.
-Detyrimet nga taksapaguesit familjarë që kanë ndaj Bashkisë Himarë për taksa e tarifa vendore në fund të vitit 2025 janë në vlerën 135,009,522 lekë.
-Detyrimet nga individ për taksën e infrastrukturës nga legalizimet në fund të vitit 2025 janë në vlerën 4,015,918 lekë.
-Detyrimet nga subjektet private për tarifën e autorizimit për leje të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve në fund të vitit 2025 janë në vlerë 4,500,000 lekë.
- Nga auditimi i të ardhurave tatimore konstatohet se për vitin 2024 janë realizuara në shumën 27%. Niveli i realizimit të planit është rritur nga 27% në 84.23%, duke shënuar një rritje prej 57.23%, duke treguar përmirësim të dukshëm në arkëtimin dhe administrimin e të ardhurave.
- Teprica e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 287,712,000 lekë, vlerë për të cilën mungon analiza e sipas kategorive të debitorëve, duke sjellë mospasqyrimin e plotë të drejtave të konstatuara.
- Mungojnë inventarët kontabël dhe fizik për gjendjet në pasqyrat financiare të llogarive: 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 182,687,308 lekë, tepricën e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 22,620,865,178 lekë; tepricën e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,528,215,355 lekë; tepricën e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 915,522,382 lekë; tepricën e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"* në vlerën 23,747,353 lekë; tepricën e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 44,402,639 lekë; tepricën e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 21,636,289 lekë. Kjo situatë ndikon në besueshmërinë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Tepricat e llogarive 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhur me to"* dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në shumën 0 lekë. Sipas raportimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave për detyrimet e prapambetura për vitin 2025 për gjithë njësitë shpenzuese rezulton se Bashkia Himarë ka detyrime të prapambetura deri në fund të dhjetorit të vitit 2025 në shumën 2,000,000 lekë për fatura të palikujduara për shpenzime për investime. Ndërsa referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit sipas sistemit "accrual" detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në fund të vitit 2025 rezultojnë në shumën 48,492,482 lekë. Pra mungon një evidentim i saktë dhe i plotë i detajuar i detyrimeve që ka bashkia ndaj të tretëve në fund të periudhës ushtrimore.
- Për disa llogari në pasqyrën e pozicionit financiar mungon informacioni kontabël dhe dokumentacioni mbështetës si; llog. 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* në shumën 2,399,340,108 lekë, llog.*26 " Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* në shumën 231,278,350 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, llog. 109 *"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata"* në shumën 23,230,799,929 lekë, e trashëguar në vite.
- Gjendja e llogarisë sintetike *70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"* në pasqyrën e performancës paraqitet në shumën 2,788,598,682 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin të ardhurat nga taksat dhe tatimet janë në shumën 2,945,875,792 lekë, pra me një deviacion prej 157,277,110 lekë. Nuk janë plotësuar llogaritë analitike të ardhurave tatimore dhe jo tatimore.
- Gjendja e llogarive analitike 7200-7201 *"Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)"* në pasqyrën e performancës paraqitet në mënyrë të gabuar në shumën 304,161,341 lekë, pasi sipas aktrakordimit me thesarin është 197,010,542 lekë.
- Gjendja e llogarisë 787 *"Tërheqje nga seksioni i investimeve"* në shumën 1,456,989,769 lekë që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës të pasqyruar një herë në atë vit dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.
Analizën e shpenzimeve konstatohet se,
- Gjendja e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* në pasqyrën e performancës për vitin 2025 paraqitet në shumën 212,804,197 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 210,947,910 lekë, duke u mbivlerësuar për shumën 1,856,287 lekë.
- Gjendja e llogarisë *601 'Kontribute për sigurime"* në pasqyrën e performancës për vitin 2025 paraqitet në shumën 35,161,047 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 33,334,597 lekë, duke u mbivlerësuar për shumën 1,826,450 lekë.
- Gjendja e llogarisë *602 "Blerje mallra e shërbime"* në pasqyrën e performancës për vitin 2025 paraqitet në vlerën 175,366,648 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 226,560,887 lekë, pra është paraqitur 51,194,239 lekë më pak.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon: -
-Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksave dhe tarifa vendore, në vlerën 314,808,552 lekë.
-Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të shqyrtojë dokumentacionin financiar në vite për analizimin e shumave të paraqitura në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që të kontabilizojë vlerat debitore nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të drejtave për arkëtim të debitorëve në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogaritë e tjera të lidhura me to.
-Drejtoria e Financës të marrë masa për të saktësuar llogarinë në pasqyrën e pozicionit financiar pasi mungon informacioni kontabël dhe dokumentacioni mbështetës si; llog. 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* në shumën 2,399,340,108

lekë, llog.*26 " Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* në shumën 231,278,350 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, llog. 109 *"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata"* në shumën 23,230,799,929 lekë, e trashëguar në vite.
-Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të kryejë veprimet në kontabilitet për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë detyrimeve ndaj të tretëve në llogaritë e klasës 4, duke kontabilizuar të gjitha faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh të papaguara, me qëllim që pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor të japin një informacion të saktë e të besueshëm në lidhje me detyrimet afatshkurtra.
-Drejtoria Ekonomike të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të sigurojë që të bëhet kontabilizimi i saktë i veprimeve me fondet dhe transaksioneve financiare në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e performancës, duke i rakorduar me Thesarin dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar[1]: *i kualifikuar*

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Himarë, për periudhën ushtrimore 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të përformances financiare, të fluksit të mjeteve monetare (cash floë), të ndryshimit të aktiveve neto/flukseve neto dhe shënimet shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Himarë nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Në dhënien e opinionit, në kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 21,693 mijë lekë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Teprica e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm",* si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 287,712,000 lekë, vlerë për të cilën mungon analiza e sipas kategorive të debitorëve, duke sjellë mos pasqyrimin e plotë të drejtave të konstatuara.
- Mungojnë inventarët kontabël dhe fizik për gjendjet në pasqyrat financiare të llogarive: 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 182,687,308 lekë, tepricën e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 22,620,865,178 lekë; tepricën e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,528,215,355 lekë; tepricën e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 915,522,382 lekë; tepricën e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"*

[1] - Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së".

në vlerën 23,747,353 lekë; tepricën e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 44,402,639 lekë; tepricën e llogarisë 218 "Inventar ekonomk" në vlerën 21,636,289 lekë. Kjo situatë ndikon në besueshmërinë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
- Tepricat e llogarive 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhur me to"* dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në shumën 0 lekë, kur sipas raportit vjetor të vetëvlerësimit paraqiten në shumën 1,974,600 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin në shumën 48,492,482 lekë, duke sjellë një evidentim të pasaktë të detyrimeve ndaj të tretëve.
- Për disa llogari në pasqyrën e pozicionit financiar mungon informacioni kontabël dhe dokumentacioni mbështetës si; llog. 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* në shumën 2,399,340,108 lekë, llog.*26 " Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* në shumën 231,278,350 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, llog. 109 *"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata"* në shumën 23,230,799,929 lekë, e trashëguar në vite.
- Në pasqyrën e performancës janë paraqitur gabim gjendjet e llogarive: *70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"* rezulton e mbivlerësuar në shumën 157,277,110 lekë, 7200-7201 *"Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)"*rezultojnë të mbivlerësuara në shumën 107,150,799 lekë, *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* rezulton e mbivlerësuar për shumën 1,826,450 lekë, *601 'Kontribute për sigurime"* rezulton e mbivlerësuar për shumën 1,826,450 lekë, *602 "Blerje mallra e shërbime"* rezulton e nënvlerësuar në shumën 51,194,239 lekë, *604 "Transferime korente te brendshme"* rezulton e mbivlerësuar në shumën 11,967,600 lekë, seksioni "Shpenzime të tjera" paraqitet në shumën 517,423,198 lekë, vlerë për të cilën nuk ka analizë dhe informacion. Gjendja e llogarisë 787 *"Tërheqje nga seksioni i investimeve"* në shumën 1,456,989,769 lekë që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës të pasqyruar një herë në atë vit dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 389/1 prot., datë 15.04.2026 *"Auditim Financiar në Bashkinë Himarë"*, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.04.2026 deri në datë 29.05.2026, në subjektin Bashkia Himarë u krye "*Auditim Financiar*" për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2025, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. V. B, *përgjegjës grupi*
2. F. Ç, *auditues*
3. I. Sh, *auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.

Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Qëllimi është vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Identifikimi i çështjes:
Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Himarë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiare në fuqi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.
Strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Kryetari i Bashkisë Himarë *(Administratori i Përgjithshëm),* në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësisë *e Nëpunësit Zbatues* (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Himarë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. *Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kuadrin rregullues mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiar* të llogaridhënies vjetore; ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

4. Përgjegjësitë e Audituesve.
Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të ardhurave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Kuadrin e Praktikave Profesionale dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
d) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
e) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)
f) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;
Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materiali tetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në

Bashkinë Himarë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

5. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë Shtetit".

- Ligji nr. 139/2015 *"*Për vetëqeverisjen vendore*",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore*";*
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*",* i ndryshuar*;*
- Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar*;*
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *"Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"*
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",*
i ndryshuar*;*
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore*
të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*,
-UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "*Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*";
-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
-Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit.
ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" .

ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
ISSAI 200 "*Parimet e auditimit financiar*" dhe
ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i stadardeve te auditimit financiar"
ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC;
Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*".
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
Rregullore e brendshme *"Mbi procedurat e auditimit në KLSH"*;
Rregullore e brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"*;

7. Metodat e auditimit*:*
Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Sa më sipër, audituesit kanë aplikuar auditim *i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar.* Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:
- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe - Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.
Nga ana e grupit të auditimit auditohen procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë:

- *Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë gabime. *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi i MF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

- *Kontrolli i vlerësimit.*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi.*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Himarë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të 17 influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja . Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit*:*

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në subjektin "Bashkia Himarë", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Himarë është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*".



Pozicioni gjeografik: Bashkia Himarë bën pjesë në Qarkun e Vlorës. *Zona Gjeografike*: Bashkia e re e Himarë kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastër dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023 Himara ka 8.328 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 27,049 banorë (përfshirë të gjitha njësitë administrative: Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht)banorë. Me sipërfaqe prej 399.62 km^2, densiteti i popullsisë në bazë të censusit rezulton vetëm 13.7 banorë/ km^2 ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 47 banorë/ km^2.

Njësitë administrative përbërëse janë: Himarë, Lukovë dhe Horë Vranisht.

I .Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK –së,.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Himarë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Mjedisi i kontrollit

Në lidhje me parimin 1 *"Angazhimin për integritet dhe vlerat etike"*

- Bashkia Himarë ka të miratuar një Rregullore të Brendshme për parandalimin e Konfliktit të interesit, respektivisht në nenin 39 janë përfshihen rastet e konfliktit të interesit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Në nenin 8 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë rregulla e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Brenda institucionit mungon sistemi mbi menaxhimin dhe kontrollin e burimeve njerëzore, për respektimin e orarit zyrtar të punës.

- Në Rregulloren e Brendshme në nenin 5 janë përcaktuar parimet kryesore, parimi i barazisë, i ligjshmërisë, i ndalimit të konfliktit të interesave, i mbrojtjes së interesit publik, i vazhdimësisë, i transparencës, i ndershmërisë dhe parimi i bashkëpunimit. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të këtyre parimeve. Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.

- Kryetari i bashkisë organizon pritje me qytetarët në lidhje me Ankesat, një ditë në javë. Çdo shtetas që do të takojë Kryetarin regjistrohet paraprakisht në njësinë e komunikimit dhe pritjes së qytetarit.

Në lidhje me parimin 2 "*Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*"

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxheriale janë përcaktuar që në rregullore e brendshme dhe veprohet në bazë tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA).Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave" Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2021 me shkresën nr. prot. 249, datë 28.02.2022.

- Titullari merr opinione për përformances e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 "*Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*"

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Himarë ka të hartuar Planin e Zhvillimit Strategjik. Në dokumentet e PBA-ve nuk ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre. Po ashtu dhe për organizimet e tryezave të rrumbullakëta me palët e treta si grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun nuk është mbajtur protokoll i veçantë, pavarësisht se kjo gjë është parashikuar në Rregulloren e brendshme neni 24 "Seancat e këshillimit". Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.
- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, po vetëm përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.
- Bashkia Himarë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për këtë njësi vendore.
- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte përformances.

Në lidhje me parimin 4 *"Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave"*
- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune por nuk janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.
- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, ku në Rregulloren e Brendshme nuk përcaktohet procedura që duhet të ndiqet për rekrutimin dhe plotësimin e dosjes, dhe çfarë të dhënash e dokumentacioni duhet të përmbajë dosja e punonjësit. përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin. masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Himarë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
- Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organi gramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.
- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Në lidhje me parimin 5 *"Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale".*

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Menaxhimi i Riskut

Në lidhje me parimin 6: *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva*.

Bashkia Himarë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operacion ale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të përformances financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: *"Njësia Publike identifikon dhe analizon ris qet për arritjen e objektivave"*

Në Bashkinë Himarë nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj , pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.

Në lidhje me parimin 8: *"Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".*

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion "Koordinatori i Riskut", ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.

Referuar këtij komponenti të MFK rezulton se nuk është realizuar. NA nuk ia ka deleguar këtë funksion ndonjë nëpunësi të Aparatit të Bashkisë bashkë me detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij funksioni. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2019 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 9 pika 3, neni 10, neni 11 pika 2 .

Në lidhje me parimin 9: " *Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*".

Bashkia Himarë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për

ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Aktivitetet e Kontrollit

Në lidhje me parimin 10: " *Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së procese të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde te zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.).
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA)
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhornohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë"

- Bashkia Himarë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Në lidhje me parimin 12: *"Njësi publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave".*

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

Informimi dhe komunikimi

Në lidhje me parimin 13: *"Njësia Publike merr gjeneron dhe përdor informacion cilësor".*

Drejtuesit në Bashkinë Himarë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit çdo 4-mujor dhe vjetor, me qëllim paraqitjen pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit
- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

Në lidhje me parimin 14: *Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm*

Është në përdorim emailit zyrtar komunikimi zyrtar mes menaxherëve dhe punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor si dhe nëpërmjet postës elektronike zyrtare.

Në lidhje me parimin 15: *Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm*

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në Seksionin

Etika dhe Komunikimi Zyrtar, Nenin 6 “Etika dhe kodi I veshjes”, Neni 7 “Komunikimi verbal dhe zyrtar”

Nga bashkia Himarë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të parashikuara dhe në rregulloren e brendshme, por mungon dokumenti i evidentimit të konsultimit publik të kryer.

Monitorimi

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë Impakti dhe produkti.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
- Në Bashkinë Himarë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nuk janë realizuar.
- Në Bashkinë Himarë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Në lidhje me parimin 17: “*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.*

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23, 24.

1.1.Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm

Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Himarë ka qenë pjesë përbërëse e Strukturës Organizative të Bashkisë Himarë.

Për vitin 2023, Me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB 56, datë 24.11.2022, i ndryshuar me VKB nr. 38, datë 07.08.2023, me këtë përbërje, pasqyra:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual 2023	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M. B.	Përgjegjës sektori	Ekonomi-Plan	2008
2	A. K.	Specialist	Fianancë Kontabel	Jo
3	Vakant			

Për vitin 2024, Me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB 56, datë 24.11.2022, i ndryshuar me VKB nr. 38, datë 07.08.2023. Vendimi nr. 28, datë 29.08.2024 me këtë përbërje, pasqyra:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual 2023	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M. B.	Përgjegjës sektori	Ekonomi-Plan	2008
2	A. K.	Specialist	Fianancë Kontabel	Jo
3	Vakant			

Për vitin 2025, Me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm me VKB nr. 28, datë 29.08.2024 , me këtë përbërje, pasqyra:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual 2023	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M. B.	Përgjegjës sektori	Ekonomi-Plan	2008
2	Vakant			
3	Vakant			

Nga të dhënat si më sipër rezulton se drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është i certifikuar dhe audituesit e brendshëm nuk janë të çertifikuar si "Auditues të brendshëm". Për vitet 2023-2024 Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon me dy punonjës dhe për vitin 2025 ka funksionuar me një punonjës, veprime në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik", neni 11 pika 2, germa "**ç"** ku përcaktohet..... *"Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm."*

-Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor, analiza sipas llojeve dhe gjetjeve.

Në zbatim të nenit 14, pika b, të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik" dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministria e financave , me shkresën nr. 100, datë 25.10.2016, Bashkia Himarë me shkresë nr. 4287/1, datë 09.11.2022, ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik** 2023-2025 dhe atë **vjeto**r për vitin 2023, me shkresë nr. 4269/1, datë 16.11.2023, ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik** 2024-2026 dhe atë **vjeto**r për vitin 2024 dhe me shkresë nr. 5421/1, datë 04.11.2025, ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik** 2025-2027 dhe atë **vjeto**r për vitin 2025.

Për vitin 2023 janë parashikuar gjithsej 4 auditime dhe janë realizuar 2 auditime, sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Subjektet	Niveli vlerësimit të riskut	Realizimi
1	*Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social(sistemi i prokurimeve)*	*I Lartë*	*Jo*
2	*Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social(sistemi i menaxhimit buxhetor)*	*I lartë*	*Jo*
3	*Nj.A Horë-Vranisht*	*I Ulët*	*Po*
4	*Drejtoria e Kadastrës Bashkia Himarë*	*I Mesëm*	*Po*

Për vitin 2024 janë parashikuar në planin vjetor 3(tre) auditime dhe janë realizuar 3 (tre) auditime sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Nr	Subjektet	Niveli vlerësimit te riskut	Realizimi
1	*Verifikimi i zbatimit të Rekomandimeve të KLSH(2021)*	*I mesëm*	*Po*
2	*Drejtoria e Intergrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimit Social*	*I mesëm*	*Po*
3	*Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes*	*I mesëm*	*po*

Për vitin 2025 janë parashikuar 2 auditime dhe janë realizuar 2 auditime, sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Subjektet	Niveli vlerësimit te riskut	Realizimi
1	*Nj.A Lukovë*	*I Ulët*	*Po*
2	*Verifikimi i zbatimit të Rekomandimeve të KLSH(2021)*	*I lartë*	*po*

Nga auditimi në lidhje me raportimin e NJAB, rezulton se në përputhje me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Financave, me Urdhër nr. 100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm", nuk janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB e Ministrisë së Financave, raportet periodike dhe vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e Auditit të Brendshëm, përkatësisht për vitet 2023 dhe 2025. Për vitin 2024 janë hartuar dhe dërguar me shkresën nr. nr. 650/1 prot., datë 24.01.2025.

- *Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.*

Nga auditimi rezulton se në të gjitha rastet janë respektuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB) miratuar me urdhrin e Ministrit te Financave me nr. 100, dt.25.10 2016 "Për miratimin e Manualit te Auditimit të brendshëm ne sektorin publik".

- Në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë , për çdo rast të angazhimit te auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, për çdo auditim janë hartuar edhe deklaratat e paanësisë . Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatës, për çdo rast është hartuar programi i angazhimit duke qene në strukturë 1 audites ka zbatuar të gjitha pikat përkatëse te programit.

Hartimi i projekt– raporteve dhe raporteve finale është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit, janë hartuar dhe dërguar në subjekt edhe memorandumet e auditimit të cilat janë dërguar në subjekt me shkresa të veçanta dhe të protokolluara.

Për çdo rast si projekt-raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual.

Janë respektuar kërkesat e manualit në hartimin e materialeve të auditimit në auditimet e kryera në subjektet në lidhje me hartimin e:

a-Letrave të punës së auditimit në fazën përgatitore të programit

b-Letrave të punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të projekt–raportit dhe raportit final nga audituesit.

c-Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit.

Konstatime:
1) *Njësia e Auditit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me dy punonjës, audituesit e brendshëm nuk janë të çertifikuar si "Auditues të brendshëm" veprim në papajtueshmëri me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik", neni 11 pika 2, "**c"** ku përcaktohet..... audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm."*
2)*U konstatua se për periudhën 2023 plani i auditimeve nuk është realizuar në masën 100%. Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: z. J. G, zj. B. B. dhe A. B. me detyrë ish-kryetar të Bashkisë Himarë dhe z. V. T. me detyrë Kryetar i Bashkisë Himarë, z. A. X. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore për periudhën janar 2023-2024 dhe z. E. P. për periudhën 2025, zj. M. B. me detyrë ish-Përgjegjës i Njësisë së Aditit të Brendshëm për periudhën 01.01.2023 deri me datë 31.12.2025*.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;
2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduar, vendimet gjyqësore vendimet e shpronësimeve.

Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025, 2024-2026 dhe 2025-2027
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 u konstatua se:
- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 111 datë 28.07.2020 për PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, ndërsa për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 631, datë 16.10.2025.
- Është përgatitur dhe miratuar kalendari dhe tavanet përgatitore për PBA 2023-2025 me VKB nr.58 datë 24.11.2022, PBA 2024-2026 me VKB nr.13 datë 31.03.2023 dhe për PBA 2025-2027 me VKB nr.11, datë 05.04.2024 në bazë të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1.
- Pas miratimit të tavaneve përgatitore nuk është hartuar Udhëzimi i Kryetarit të Bashkisë për përgatitjen e 3 PBA-ve 2023-2025, 2024-2026 dhe 2025-2027
- Faza e parë e përgatitjes të PBA 2023-2025 është miratuar me VKB nr.35 datë 05.07.2022, ndërsa për PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 mungon miratimi me VKB
- Tavanet përfundimtare janë miratuar për PBA 2023-2025 me VKB nr.38 datë 01.08.2022, për PBA 2024-2026 me VKB nr.40, datë 22.09.2023, ndërsa për PBA 2025-2027 mungon miratimi me VKB.
- Për dokumentin përfundimtar të PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 mungon miratimi me VKB, ndërsa për PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr.1, datë 30.01.2025 në mospërputhje me Udhëzimin plotësues të MF nr.4, datë 28.03.2024 Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"pika 9/a, me Udhëzimin plotësues të MF nr.21 datë 07.07.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027*" kreu II "Afatet për përgatitjen e buxhetit" pika 4 në të cilën përcaktohet: "*Brenda datës 15 shtator, njësie vetëqeverisjes vendore dërgon në MF dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë*."
Konkluzion: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 rezultoi se mungojnë miratimet me VKB për dokumentet e PBA 2024-

2026 dhe PBA 2025-2027 faza e parë, për tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 dhe për fazën përfundimtare të PBA 2023-2025 e PBA 2024-2026 si dhe nuk janë publikuar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*" pikat 20, 76, 86, 87, 88.

Bashkia Himarë ka përgatitur buxhetin sipas metodologjisë së re të kodifikimit të programeve dhe bazuar në Udhëzimin e MFE nr.6 datë 28.02.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026*"dhe Udhëzimin plotësues të MF nr.4, datë 28.03.2024"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027". PBA 2024-2026 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar shoqëruar me 7 shtojcat (pasqyrat anekse) dhe me relacion shpjegues, të cilët përmbajnë: rolin dhe qëllimin e PBA-së, vështrim të përgjithshëm të njësisë dhe orientimin afatgjatë saj, të ardhurat dhe shpenzimet, planin e shpenzimeve 2024-2026, sipas programeve buxhetore, detyrimet e prapambetura, treguesit financiarë dhe rreziqet financiare e fiskale.
Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA-ve 2023-2025 dhe buxhetit vjetor, rezulton se mungojnë kërkesat shkresore për programimin e PBA dhe buxheteve vjetore nga Njësitë Administrative, nga njësitë vartëse dhe nga Drejtorët e Drejtorive të bashkisë Himarë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesat publike.

Konkluzion: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2024 - 2026 dhe buxhetit vjetor, rezulton se <u>mungojnë</u>**:** udhëzimi i brendshëm i nxjerrë nga titullari për përgatitjen e PBA të njësisë së vetëqeverisjes, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Himarë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga GMS dhe EMP për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, si dhe dëgjesat publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim në kundërshtim me:
- Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*" pika 67,71,72,83,85
- Udhëzimin nr.6 datë 28.02.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026*"pikat 7 dhe 11.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2023-2025, 2024-2026 dhe 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2023-2025 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	195,652	16%	134,052	12%	134,200	12%
2	Sigurime (601)	85,618	7%	23,240	1.4%	24,275	2.2%
3	Shpenzime operative (602)	292,805	24%	390,062	35%	390,062	35%
4	Shpenzime (603)	3,854	0.3%	6,354	0.4%	6,354	0.6%
5	Shpenzime (604)	4,573	0.3%	5,805	0.3%	5,805	0.5%
6	Shpenzime (606)	7,500	0.6%	6,000	0.4%	6,000	0.5%
7	Shpenzime (609)		%		%		%
	Shp. principal + interes		%		%		%

8	Shpenzime për investime (230-231)	689,557	56%	527,979	48%	533,295	48%
	TOTALI	**1,229,779**	**100%**	**1,093,492**	**100%**	**1,099,991**	**100%**

Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2024-2026 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	126,550	8%	128,250	8%	130,000	7%
2	Sigurime (601)	26,150	2%	26,250	2%	26,800	2%
3	Shpenzime operative (602)	383,860	24%	394,560	24%	406,200	23%
4	Shpenzime (603)	5,000	0.3%	5,000	0.5%	5,000	0.3%
5	Shpenzime (604)	5,000	0.3%	5,000	0.5%	5,000	0.3%
6	Shpenzime (606)	4,000	0.2%	4,000	0.2%	4,000	0.2%
7	Shpenzime (609)		%		%		%
	Shp. principal + interes		%		%		%
8	Shpenzime për investime (230-231)	1,077,232	66%	1,095,945	66%	1,158,537	67%
	TOTALI	**1,627,792**	**100%**	**1,659,005**	**100%**	**1,735,537**	**100%**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	271,770	13%	272,151	14%	271,201	14%
2	Sigurime (601)	63,251	3%	63,280	3%	63,330	3%
3	Shpenzime operative (602)	532,486	26%	568,468	29%	545,268	28%
4	Shpenzime (603)	12,500	0.4 %	12,500	0.6%	12,500	0.6%
5	Shpenzime (604)	8,500	0.4%	8,500	0.4%	8,500	0.4%
6	Shpenzime (606)	9,000	0.4%	9,000	0.5%	9,000	0.5%
7	Shpenzime (609)		%		%		%
	Shp. principal + interes		%		%		%
8	Shpenzime për investime (230-231)	1,132,653	56%	1,046,215	53%	1,043,615	53%
	TOTALI	**2,030,160**	**100%**	**1,980,114**	**100%**	**1,954,414**	**100%**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar programeve buxhetore afatmesme rezulton se peshën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për investime, shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzimet për paga e më konkretisht:

- zëri 600 "Shpenzimet për paga" ndaj shpenzimeve totale ka një peshë specifike rreth 12% në PBA 2023-2025, rreth 8% në PBA 2024-2026 dhe rreth 13-14% në PBA 2025-2027
- zëri 602 "Shpenzime operative" ndaj shpenzimeve totale ka një peshë specifike rreth 24-35% në PBA 2023-2025, rreth 24% në PBA 2024-2026 dhe rreth 26-29% në PBA 2025-2027
- zëri 230-231 "Shpenzime për investime" ndaj shpenzimeve totale ka një peshë specifike rreth 56-48% në PBA 2023-2025, rreth 66% në PBA 2024-2026 dhe rreth 56-53% në PBA 2025-2027.

- *Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023, 2024 dhe 2024*

Buxheti **për vitin 2023** është miratuar me VKB nr. 70, datë 23.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1213/1, datë 6.1.2023. Buxheti **për vitin 2024** është miratuar me VKB nr. 27, datë 22.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1088/1datë 29.12.2023. Buxheti **për vitin 2025** është miratuar me VKB nr.42, datë 20.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1133/1 datë 30.12.2024. Plani fillestar i miratuar për vitet 2023-2024- 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2023		Plani fillestar i vitit 2024		Plani fillestar i vitit 2025	
	Të ardhurat	Të ardhurat	Shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	143.281		159,741		167,733	

2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	83,949		63,313		74,077	
3	Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore + Inst. e varësisë	580,500		618,000		1,426,523	
	Të ardhura nga debitorë të prapambetur	25,000		25,000		45,574	
	Transferta specifike			38,245		64,304	
	Granti specifik ,Mbrojtja Civile (emergjenca civile)	2,500		2,500			
4	Te ardhura te trashëguara nga 2022	928,644		906,687		1,196,603	
	Shpenzimet						
1	**Shpenz për paga (600)+ sigurime shoq e shendets (601)**		156,549		208,230		344,019
3	**Shpenzime operative (602)**		390,898		426,031		543,236
4	**Subvencione (603)**		1,000		6,000		3,000
5	Transferta tek organizatat(604 Këshilli i Qarkut)		5,805		6,280		8,500
	Emergjencat civile (604)		19,915		14,916		42,796
6	**Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)**		17,415		18,624		19,200
7	**Shpenzimet kapitale (230+231)**		1,172,292		1,133,405		2,014,063
	Total	**1,763,874**	**1,763,874**	**1,813,486**	**1,813,486**	**2,974,814**	**2,974,814**

Buxheti fillestar i viteve 2023-2024-2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat janë të barabarta me shpenzimet.

- *2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtezuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Himarë. Plani përfundimtar i shpenzimeve dhe të ardhurave **për vitet 2023-2024-2025** paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2023			Viti 2024			Vitt 2025		
	Buxheti fillestar 2023	**Ndryshim gjatë vitit 2023**	**Buxheti perfund imtar**	**Buxheti fillestar 2024**	**Ndryshimet gjatë vitit 2024**	**Buxheti perfund imtar**	**Buxheti fillestar 2025**	**Ndryshimet gjatë vitit 2025**	**Buxheti perfund imtar**
Art. 600 Paga	123,674	+24,086	147,760	176,221	+20,160	196,381	271,776	+8,690	280,466
Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore	32,875	-5,081	27,794	32,009	+7,847	39,856	72,243	-4,713	67,530
Art.602 Shpenzime operative	390,898	-3,045	387,853	426,031	-31,022	395,009	543,236	+39,255	582,491
Art.603 Subvencione	1,000	+4,000	5,000	6,000	-	6,000	3,000	+3,000	6,000
Art. 604+606+609 Transf korrente Emergj.Civile,fond rezerv+kontigj, individ, PAK e Nd.Ekon	43,135	+71,788	114,923	39,820	+93,679	133,499	70,496	+65,071	135,567
Art. 230-231 Investime	1,172,292	+81,064	1,253,356	1,133,405	+231,302	1,364,707	2,014,063	+228,306	2,242,369
Total	**1,763,874**	**+172,812**	**1,936,686**	**1,813,486**	**+321,966**	**2,135,452**	**2,974,814**	**+339,609**	**3,314,423**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Për çdo vit buxhetor janë bërë rishikimet e buxhetit të miratuara me VKB, ku janë rialokuar fondet brenda zërave të buxhetit sipas prioriteteve të ndryshuara.

Në vitin 2023 me VKB nr. 07, datë 27.02.2023 "Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë për vitit 2023" në fakt është rishikuar buxheti i miratuar i vitit 2023, janë analizuar të ardhurat

e arkëtuara dhe detyrimet kontraktore për mallra, shërbime dhe investime, duke bërë ndryshime për shtesat e miratuara me VKM dhe për lëvizje brenda fondeve buxhetore në të gjithë zërat e buxhetit si paga, shpenzime operative dhe investime.
Në vitin 2024 me VKB nr. 10, datë 05.04.2024 "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2024" në fakt është rishikuar buxheti i miratuar i vitit 2024 dhe realizimi i 3-mujorit të parë, janë analizuar të ardhurat e arkëtuara dhe detyrimet kontraktore për mallra, shërbime dhe investime, duke bërë ndryshime për shtesat e miratuara me VKM dhe për lëvizje brenda fondeve buxhetore në të gjithë zërat e buxhetit si paga, shpenzime operative dhe investime
Në vitin 2025 kanë ndodhur 2 rishikime të buxhetit vjetor të miratuara me VKB nr.14, datë 02.04.2025 dhe VB nr.24,datë 09.06.2025 janë analizuar të ardhurat e arkëtuara dhe detyrimet kontraktore për mallra, shërbime dhe investime, duke bërë ndryshime për shtesat e miratuara me VKM dhe për lëvizje brenda fondeve buxhetore në të gjithë zërat e buxhetit si paga, shpenzime operative dhe investime.

➢ *2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.*

- ***Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Vlorë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Vlorë, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore. Realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie për vitet 2023-2024, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Artikulli buxhetor	Viti 2023			Viti 2024		
	Plan përfundimtar	Fakt	% realizimit	Plan përfundimtar	Fakt	% realizimit
Shpenzime për paga (600)	147,760	139,090	**94%**	196,381	158,033	**80%**
Shp për sig shoqërore/shëndetësore (601)	27,794	22,990	**83%**	39,856	26,123	**66%**
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	387,853	207,581	**54%**	395,009	209,994	**54%**
Subvencione (603)	5,000	4,000	**80%**	6,000	5,000	**84%**
Transferta tek organizatat (604)-609	114,923	67,115	**58%**	133,499	78,150	**59%**
Shpenzime për investime (230-231)	1,253,356	466,109	**37%**	1,364,707	93,423	**6.9%**
Total	**1,936,686**	**906,885**	**47%**	**2,135,452**	**570,723**	**27%**

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit paraqitet:
Për **vitin 2023** fondet buxhetore janë realizuar 906,885 mijë lekë nga 1,936,686 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 47%. Ky realizim është në nivel shumë ulët, gjë që tregon për programim optimist të buxhetit. Në këtë masë realizimi të ulët ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
a. llog.601 "Shpenzime për kontribute për sigurime" në masën 83%, llog.602"Shpenzime operative" në masën 54%, llog.604-609 "Transferta tek individët dhe organizatat" në masën 58%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë e të paargumentuara dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve.
b. Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë planifikuar fonde në shumën 1,253,355 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 466,109 mijë lekë ose ne masën 37%. Nga analiza e

investimeve theksojmë se një pjesë e investimeve janë prokuruar me vonesë në fund të vitit buxhetor. Një pjesë e projekteve nuk janë realizuar dhe një pjesë tjetër janë planifikuar me burim financimi të ardhurat e veta, ndërkohë që të ardhurat nuk janë realizuar sipas pritshmërive.

Për **vitin 2024** fondet buxhetore janë realizuar 570,723 mijë lekë nga 2,135,452 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 27%. Ky realizim është në nivel shumë ulët, gjë që tregon për programim të paargumentuar të buxhetit. Në këtë masë realizimi të ulët ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

a. llog.600 " Shpenzime për paga e shpërblime" në masën 80%, llog.601 "Shpenzime për kontribute për sigurime" në masën 66%, llog.602"Shpenzime operative" në masën 54%, llog.604-609 "Transferta tek individët dhe organizatat" në masën 59%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë e të paargumentuara dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve.

b. Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë planifikuar fonde në shumën 1,364,707 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 93,423 mijë lekë ose në masën 7%. Ky nivel i ulët realizimi vit ka patur lëvizje te titullarëve (NA) si pasojë e largimeve dhe periudhave zgjedhore si dhe ndërrimeve te stafit punonjës. Si rezultat i këtyre situatave jo normaletë zhvilluara gjatë vitit buxhetor dhe mungesës së kapaciteteve një pjesë e investimeve nuk janë kryer, një pjesë tjetër e vogël e investimeve janë prokuruar me vonesë në fund të vitit buxhetor. Një pjesë e projekteve nuk janë realizuar që janë planifikuar me burim financimi të ardhurat e veta, pasi të ardhurat nuk janë realizuar sipas pritshmërive.

Realizimi i **buxhetit 2025** për shpenzimet në mënyrë të përmbledhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		603-609 (transf indivi)		230-231(investime)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia (Aparati)	229,514	208,903	55,554	34,630	347,242	230,472	121,594	70,401	2,213,869	542,183	2,967,773	1,086,589
Ndër. e Shërbim Publike	50,951	44,254	11,976	7,427	235,249	138,463	19,973		28,500	24,304	346,650	214,449
TOTALI	**280,465**	**253,157**	**67,530**	**42,057**	**582,491**	**368,935**	**141,567**	**70,401**	**2,242,369**	**566,487**	**3,314,423**	**1,301,038**
% e realizimit		90%		62%		63%		50%		25%		39%

Realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie **për vitin 2025**, sipas zërave të buxhetit referuar akt-rakordimit me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	**Emërtimi I llogarive**	**Plani perfundimtar**	**Fakti**	**% e realizimit**
1	paga (600)	280,465,705	253,157,228	90 %
2	Sigurime (601)	67,529,933	42,057,285	62 %
3	Shp.operative (602)	582,491,869	368,935,636	63 %
4	Subvencion (603)	6,000,000		0 %
5	Transf.tek organizata (604)	8,500,000	5,816,345	68 %
6	Transf.tek individ nd.ekon+invalid (606)	68,616,000	64,584,628	94 %
7	Fondi rezervë+kontigjence (609)	58,450,893		0 %
9	Shp.investime AA jo materiale (230)	162,800,000	44,425,635	27 %
10	Shp.investime AA materiale (231)	2,079,568,845	522,060,960	25 %
	Shuma	**3,314,423,245**	**1,301,037,717**	**39 %**

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit paraqitet:

Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 1,301,038 mijë lekë nga 3,314,423 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 39%. Ky realizim është në nivel shumë ulët, gjë që tregon për programim optimist të buxhetit. Në këtë masë realizimi të ulët ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

a. llog.601 "Shpenzime për kontribute për sigurime" në masën 62%, llog.602"Shpenzime

operative" në masën 63%, llog.604 "Transferta tek individët dhe organizatat" në masën 68%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë e të pa argumentuara dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve.
b. Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë planifikuar fonde në shumën 2,242,369 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 566,487 mijë lekë ose ne masën 26%. Nga analiza e investimeve rezulton se në vitin 2025 janë mbartur vlera pjesore kontratash të pa mbyllura për likuidim për të cilat ka mungesë dokumentacioni, një pjesë e investimeve nuk janë prokuruar ose janë prokuruar me vonesë në fund të vitit buxhetor. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të lëvizjeve të shpeshta të stafit në kohë paszgjedhore.

- *Raportet e Monitorimit.*

Në bazë të Ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6 për vitet 2023-2024-2025 janë përgatitur raporte vjetore për procesin e zbatimit të buxhetit, realizimin e tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre.
Për vitin 2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi janar-dhjetor 2023" me shkresën nr.1509 prot, datë 21.03.2024
Për vitin 2024 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2024" me shkresën nr.2489/1 prot., datë 18.03.2025
Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi janar-prill 2025" me shkresën nr.3930 prot., datë 26.05.2025,
"Raport monitorimi janar-gusht 2025" me shkresën nr.7329 prot., datë 29.09.2025,
"Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2025" me shkresën nr.1878/1 prot., datë 21.05.2026.
Zbatimi i buxheteve vjetore për vitet 2023-2024-2025 sipas zërave të buxhetit të paraqitura në raportet vjetore të monitorimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
	Plan	Fakt	% reali	Plan	Fakt	% reali	Plan	Fakt	% reali
Art. 600 Spenz per Paga	146,625,275	140,006,208	95.5	196,969,004	158,033,525	80.5	274,884,000	249,095,000	90.6
Art. 601 Sig. shoq.e shënd	27,793,545	24,652,989	88.7	39,602,120	26,158,622	65.5	75,443,000	41,351,000	54.8
Art.602 Shpenz operative	398,943,466	300,757,621	75.4	424,542,008	209,994,032	52	580,051,000	367,575,000	63.4
Art.603 Subven cione	5,000,000	5,000,000	100	1,000,000		0%	6000,000		0%
Art.604 K.Qark e Emergj Civ	5,805,000	5,805,000	100	21,860,470	5,807,373	26.6	8,500,000	5,816,000	68.4
Art.606 Ndih Ekon e PAK	6,000,000	1,500,000	25	73,945,632	72,342,537	97.8	9,000,000		0%
Art.609 Fond rezerv+ kontigj	24,914,148			36,692,470		0%	61,995,000		0%
Art.230 Shp. Stud-projekti	36,550,000	18,199,559	49.8	54,000,000	191,765	0.4	122,800,000	4,426,000	3.6
Art.231 Shpenz investime	1,038,851,461	481,545,277	46.4	1,284,116,621	93,231,138	7.3	2,014,539,000	485,109,000	24
Shuma	**1,690,482,895**	**977,466,654**	**57.8**	**2,132,728,325**	**565,758,992**	**26.7**	**3,153,212,000**	**1,158,822,000**	**36.7**

Konkluzion: Nga auditimi rezulton se në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitet 2023-2024-2025 treguesit e realizimit të buxhetit nuk janë paraqitur sipas akt-rakordimit me thesarin, duke sjellë pasaktësi në raportim. Për vitet 2023 dhe 2024 mungojnë raportet periodike 4-mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
Gjithashtu raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Kreu IX, neni 48**,** me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, Kreu VI, pikat 266-270.

➢ ***2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Në miratimet e buxheteve fillestare dhe në rishikimet e buxheteve për vitet 2023-2024-2025 janë parashikuar si zë buxheti për

shpenzimet për detyrimet e prapambetura, ku sipas miratimeve të buxheteve fillestare paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.i llog.	Lloji I detyrimeve	Detyrimi i mbetur deri 01.01. 2023	Detyrimi i mbetur deri 01.01. 2024	Detyrimi i mbetur deri 01.01. 2025	Detyrimi i mbetur deri 01.01. 2026
230-231	Për investime	450,236,361	313,657,636	999,214,772	2,114,955,000
602	Për mallra e shërbime	91,304,014	71,860,612	116,777,963	47,558,000
	Shuma	**541,540,375**	**385,518,248**	**1,115,992,735**	**2,162,513,000**

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozion nga Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit rezulton se në miratimet e buxheteve fillestare dhe në rishikimet e buxheteve për vitet 2023-2024-2025 në detyrimet e prapambetura janë evidentuar në mënyrë të gabuar pjesa e pa shlyer e kontratave të lidhura dhe jo vlerat e faturave të mbërritura në bashki të palikujduara.

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara*

Detyrimet e palikujduara nuk janë raportuar në mënyrë periodike, pasi mungojnë shkresat përcjellëse me treguesit e detyrimeve të prapambetura çdo 4-mujor të dërguara pranë Ministrisë së Financave. Ndërsa sipas emaile-ve për dërgimin në MF të raporteve vjetore të vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor të viteve buxhetore 2023-2024-2025 detyrimet e prapambetura paraqiten në Aneks

Ndërsa sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Financave detyrimet e prapambetura të publikuara për vitet 2023-2024-2025 jaë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në milion/lekë

Stoku i Detyrimeve në fund te vitit ushtrimor	Vendim Gjyqës	Shërbim	Mirëmbajt	Investim	Rimburs i TVSH	Mallra	Të tjera	Sigur. Shoq	Sigur. Shëndet	Të Ardh Person	Tatime të Tjera	**Total**
B.Himarë Djetor 2023												
B. Himarë Dhjetor 2024	-	-	0.7	2.0	-	-	0.2	-	-	-	-	**2.9**
B. Himarë Dhjetor 2025	-	-	-	2.0		-	-	-	-	-	-	**2.0**

- ✓ Referuar raportit vjetor të vetëvlerësimit të email-it datë 25.02.2026 për situatën e gjendjes financiare për periudhën **janar-dhjetor 2025** Bashkia Himarë detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve janë **në shumën prej 1,974,600 lekë**, që i përket faturave të palikujduara për investime.

  - Në fund **të vitit 2023** detyrimet e prapambetura janë në shumën **6,369,248 lekë, e** cila përbëhet nga: shuma prej 2,990,948 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 845,696 lekë e faturave të palikujduara për furnizim me energji elektrike, shuma prej 746,204 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime për mirëmbajtje, shuma prej 1,786,400 lekë detyrim për rimbursim të TVSh**.**
  - Në fund **të vitit 2024** detyrimet e prapambetura janë në shumën **2,895,052 lekë, e** cila përbëhet nga: shuma prej 1,974,600 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 174,208 lekë e faturave të palikujduara për furnizim me energji elektrike, shuma prej 746,204 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime për mirëmbajtje,

  Për këto detyrime të prapambetura mungon analiza e detajuar me faturat përkatëse me të dhënat e tyre.

- ✓ Referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit sipas sistemit "accrual" detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në fund të viteve buxhetore janë:

  - **Për vitin 2023** detyrimi i mbetur në fund të vitit është **në shumën prej 4,582,848 lekë**, e cila përbëhet nga: shuma prej 2,990,948 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma

prej 845,696 lekë e faturave të palikujduara për furnizim me energji elektrike, shuma prej 746,204 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime për mirëmbajtje**.**

- **Për vitin 2024** detyrimi i mbetur në fund të vitit është **në shumën prej 4,482,752 lekë**, e cila përbëhet nga: shuma prej 3,573,922 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 895,102 lekë e faturave të palikujduara për furnizim me energji elektrike, shuma prej 13,728 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime për mirëmbajtje**.**
- **Për vitin 2025** detyrimi i mbetur në fund të vitit është në **shumën prej 48,492,482 lekë,** e cila përbëhet nga: shuma prej 39,014,865 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 695,988 lekë e faturave të palikujduara për furnizim me energji elektrike, shuma prej 8,781,629 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime për mirëmbajtje**.**

✓ Sipas pasqyrave financiare detyrimet e prapambetura të akumuluara në llogarinë e klasës 4 në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 dhe vitit 2025 janë në shumën 0 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve rezulton se për të tre vitet 2023-2024-2025 si planifikimi për financim dhe ndjekja e tyre është bërë duke konsideruar detyrim të prapambetur pjesën e mbetur të kontratave të pashlyer dhe jo detyrimet e lindura nga faturat e mbërritura në Bashkinë Himarë të palikujduara për blerje mallra, shërbime dhe investime. Vlerat e raportuara në raportet vjetore të vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare në fund të viteve buxhetore 2023-2024 dhe në vitin 2025 që paraqitet në shumën 1,974,600 lekë nuk shoqërohen me analiza faturash përkatëse për të argumentuar vërtetesinë dhe plotësinë e tyre. Sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Financave për detyrimet e prapambetura për vitin 2025 për gjithë njësitë shpenzuese rezulton se Bashkia Himarë ka detyrime të prapambetura në shumën 2,000,000 lekë. Referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit sipas sistemit "accrual" detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në fund të viteve buxhetore 2023-2024 janë vlera të tjera nga raportimi dhe po kështu edhe për vitin 2025 detyrimet e prapambetura rezultojnë në shumën 48,492,482 lekë, e cila nuk rakodon me raportimin. Këto pasaktësi në evidentimin e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve e vërteton edhe paraqitja e tyre në shumën 0 lekë në llogaritë e klasës 4 në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrave financiare. Mosevidentimi i saktë dhe mosshlyerja e detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe moraportimi i plotë i tyre është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 1,974,600 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 0,21 % kundrejt fondeve faktike 939,236,108 lekë. Kjo situatë tregon se, Bashkia Himarë konsiderohet në situate normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% të shpenzimeve faktike në fund të vitit ushtrimor, duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33.

- *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Realizimi i buxhetit për vitet 2023-2024-2025 sipas burimit të financimit referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet si më poshtë vijon:
- Për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në masën 55 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar sektoriale në masën 21 %, transferta e kushtëzuar në masën 24%.
- Për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në masën 81%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar sektoriale në masën 14 %, transferta e kushtëzuar në masën 5%.
- Për vitin 2025 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në masën 68 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar sektoriale në masën 22 %, transferta e kushtëzuar në masën 10%.
Përsa i përket burimeve të financimit konstatohet se buxheti është përballuar më shumë nga të ardhurat e veta, tregues ky që e rrit performancën e zbatimit të buxhetit.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. L. M. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Panifikimit të Buxhetit (për periudhën 01.01.2023 – 25.08.2025) dhe zj. B. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit (për periudhën 25.08.2025 e në vazhdim), si dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi këtë drejtim të auditimit.

2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:
Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:
Veprimtaria e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore *(në vijim DAV)* mbështetet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"*; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Vendimi nr. 1, datë 05.01.2024, *"Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2024"* VKB-të për këtë qëllim si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022, e ndryshuar me VKB nr. 57, datë 26.11.2025 "Për disa ndryshime në paketën fiskale të vitit 2022".i ndryshuar.
Strukturat për mbledhjen e të ardhurave në territorin që administron kjo Bashki janë: *Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore; Drejtoria e Planifikimit, Kontroll dhe Zhvillimit të Territorit (në vijim DPZHT); Inspektorati i mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Sektori i Ujitje Kullimit, Sektori i Pyje dhe Kullotave, Sektori i Bujqësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike.*
Bashkia Himarë me Vendim nr. 38, datë 07.08.2023 si dhe me Vendimin 28, datë 29.08.2024, *"Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të bashkisë Himarë për vitin 2024"* konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1134/1 prot., datë 04.01.2024, dhe strukturën organizative me Vendimin e Kryetarit nr. 1, datë 05.01.2024, sipas drejtorive/sektorëve për vitin 2024. Për vitin 2024, DATTV për administrimin e taksave organizohet në nivel drejtorie dhe funksionon bazuar në përcaktimet e *"Rregullores së Brendshme"* të miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë të datës 19.01.2016. Ky dokument rregullon organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së DAV sipas strukturës së miratuar për vitin 2024. DTV ka në strukturën e saj 12 punonjës sipas tabelës bashkëlidhur, të cilët organizohen në 2 *(sektor)* sektorë, 3 specialistë dhe 3 inspektorë në Administratën e Bashkisë, 3 punonjës. *Për*

*periudhën Janar-Dhjetor 2024 Brenda personelit të DAV ka pasur 1 pak*ësim, ndërsa ka patur një punësim.
Drejtoria e të Ardhurave është ndarë në dy sektorë kryesorë: Sektori i Administrimit të Ardhurave dhe Statistikave dhe Sektori i Vlerësimit dhe Kontrollit të Ardhurave. Përshkrimi i organizimit të këtyre sektorëve është si më poshtë:
- Sektori i Administrimit të Ardhurave dhe Statistikave përfshin: Përgjegjës Sektori, Specialist i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Procedurave, Specialist i Statistikave dhe Borxhit, Punonjës për Hedhje të Dhënash.
Sektori i Vlerësimit dhe Kontrollit të Ardhurave përfshin: Përgjegjës Sektori, Inspektor i Regjistrimit dhe Verifikimit të Biznesit, Inspektor i Kontabilizimit dhe Verifikimit të Biznesit, Punonjës Terreni për Tatimet.
Nga auditimi rezultoi se; DATTV dhe sektorët nuk kanë një rregullore të brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së drejtorisë sipas pozicioneve të miratuara në strukturën organizative. Komisioni i Apelimit Tatimor deri më datë 31.12.2024, nuk është formuar si strukturë që të shqyrtoj kundërshtimet për njoftim-vlerësimet tatimore të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore apo strukturave të tjera të ngarkuara sipas paketës fiskale për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Por në datë 12.08.2025 nr.486 është ngritur komisioni për Apeli Tatimor. Organizimin i veprimtarisë së kësaj drejtorie sa i përket menaxhimit të dhënave (Planifikim, Njoftim detyrimi, regjistrim/crregjistrim,arkëtim) bëhet vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik programi financiar *Alfa* në vijim *"Regjistri Elektronik"* (*veçmas për çdo njësi administrative dhe vetëm për taksat/tarifat për të cilat DATTV ngarkohet për vjeljen sipas paketës fiskale pra jo për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së miratuar në paketë fiskale për vjeljen e të cilave ngarkohen drejtori/sektorë të tjera*). Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alternative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve Biznes apo sipas rastit familjarë për subjektet jo rezidentë në territorin e Bashkisë Himarë*).
Sa më sipër grupi auditimit ka dalë në konkluzionin se, Struktura e DATTV Bashkia Himarë nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të ardhurave. DATTV Bashkia Himarë organizohet në nivel drejtorie. Kjo drejtori raporton tek titullarët për rakordimin mbi planifikimin dhe realizimin e gjithë strukturës së taksave/tarifave të paketës. Në strukturën e DATTV mungojnë sektorët të domosdoshëm për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, konkretisht *"Sektori i menaxhimit të borxhit tatimor", Sektori i regjistrimit të unifikuar të subjekteve"*.
-Menaxhimi i borxhit tatimor dhe alternimi midis vlerësimit dhe planifikimit është i nevojshme të organizohen në nivel sektori sepse këto procese kanë natyra të ndryshme pune, arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe ka afate të përcaktuara. Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Himarë kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë *"Familjarë"* debitorë deri më 31.12.2023, janë 12,202 subjekte në vlerë 85,990 mijë lekë dhe për kategorinë *"Biznes"* debitorë deri më 31.12.2023, janë 82 subjekte në vlerë 5,029 mijë lekë.
-Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Himarë kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë *"Familjarë"* debitorë deri më 31.12.2024, janë në vlerë 47,687 mijë lekë dhe për kategorinë *"Biznes"* debitorë deri më 31.12.2023, janë në vlerë 287,712 mijë lekë.
-Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Himarë kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë *"Familjarë"* debitorë deri më 31.12.2025, janë në vlerë 54,109 mijë lekë dhe për kategorinë *"Biznes"* debitorë deri më 31.12.2025, në vlerë 171,283 mijë lekë.

Regjistrimi i unifikuar, bën të mundur përllogaritjen dhe përditësimet mbi vlerësimin e detyrimeve vjetore në regjistrin e tatimpaguesve në mënyrë automatike. Një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*ose përdorja e metodave alternative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve Biznes apo sipas rastit familjarë për subjektet resident dhe jo rezidentë në territorin e Bashkisë Himarë*), bën të mundur njoftimin në kohë të subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore.

-Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Sipas VKB-së nr. 52, datë 19.12.2022, *"Për miratimin e paketës fiskale në territorin e Bashkisë Himarë për vitin 2023"*, konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Vlorë, me shkresën nr.1134/1 prot., datë 04.01.2023, rezulton se Bashkia Himarë për individët familjarë dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj *(sipas kategorizimeve dhe nënkategorive veprimtarisë që ushtrojnë etj.,)*, në Bashkinë Himarë për vitin 2023, totali i të ardhurave të planifikuara ishte 1,702,982 mijë lekë. Të ardhurat sipas kategorive tregojnë përformances e mëposhtme: Realizimi nga agjentët ishte 199%, ku nga një planifikim prej 19,000 mijë lekë, u arkëtuan 37,797 mijë lekë. Të ardhura nga DRTRRSH: Realizimi ishte 129%, me 4,516 mijë lekë nga një planifikim prej 3,500 mijë lekë. Të ardhura : Realizimi paraqitet në 345%, me 27,569 mijë lekë nga një planifikim prej 8,000 mijë lekë. Të ardhura nga renta minerare: Realizimi ishte vetëm 4%, me 62 mijë lekë nga një planifikim prej 1,500 mijë lekë. Tatim mbi TAP: Realizimi ishte 155%, me 4,645 mijë lekë nga një planifikim prej 3,000 mijë lekë. Tatim i thjeshtuar fitimi: Realizimi ishte 34%, me 1,006 mijë lekë nga një planifikim prej 3,000 mijë lekë.

Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 181,000 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 131,450 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 73%. Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesë: Realizimi ishte 77%, me 26,975 mijë lekë nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë. Taksë trualli: Realizimi ishte 69%, me 2,743 mijë lekë nga një planifikim prej 4,000 mijë lekë. Të ardhurat nga bashkëpunimi me drejtoritë/sektorët e tjera Totali i realizuar nga bashkëpunimi ishte 103%, me 315,820 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 307,000 mijë lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë: Realizimi ishte 98%, me 294,024 mijë lekë nga një planifikim prej 300,000 mijë lekë. Tarifa për leje ndërtimi: Realizimi ishte 311%, me 21,796 mijë lekë nga një planifikim prej 7,000 mijë lekë. Tarifa për zënien e hapësirës publike: Realizimi ishte 140%, me 112,114 mijë lekë nga një planifikim prej 80,000 mijë lekë. Tarifa administrative: Realizimi ishte vetëm 17%, me 350 mijë lekë nga një planifikim prej 2,000 mijë lekë. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2023 paraqitet në Aneks.

Auditimi i "Regjistrit Elektronik" të Tatimeve dhe Taksave Vendore ndaj subjekteve tatim paguese, që ngarkohen dhe shlyhen nga subjektet:

Administrimi sistemit të taksave e tarifave vendore:

Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen regjistrim manual të çdo informacioni që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Himare dhe i administron në programin "Excel", në mungesë të një sistemi elektronik të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Nga ana e Sektorit të Tatim-Taksave, të dhënat janë në regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi elektronik të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave, duke rrezikuar të ketë gabime, në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave dhe editime të tabelave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin "Excel" paraqet një risk të lartë me pasojë humbjen e të dhënave të tatimpaguesve dhe/ose përllogaritje të gabuara të detyrimeve, penaliteteve dhe kamatëvonesave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave

vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7 Situata e lëvizjes se subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Poliçan bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë.

- Auditimi i "Regjistrin Elektronik" për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", nuk është vlerësuar si i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë shërbimit që ofron. Ky regjistër nuk administron të dhëna për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", në nivel lokal. Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rrezikshme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.

Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar për sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: "*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria".*

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që i shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.

Konstatim: - Nga ana e Bashkisë nuk ka të miratuar "Rregullore të brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Himarë" dhe për rrjedhojë dhe nuk ka parashikuar aspektet e gjenerimit/printimit dhe arkivimit të dhënave periodike e vjetore mbi tatimpaguesit e Bashkisë. Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues e depozitim të tij në Zyrën e Protokoll- Arkivës (*version hard copy dhe CD*) dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor. Sa më sipër, veprime jo në përputhje me përcaktimet e nenin 5/: iv) të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar përcaktohet se "Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton: iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore".

- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
- Drejtoritë cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron (Sipas strukturës së Paketës Fiskale). Këto drejtori nuk rakordojnë me SSHT-në lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 54, datë 27.11.2022, ndryshuar me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Himarë për vitin 2024-2025"dhe kërkesat të cilat

i drejtohen Bashkisë Himarë për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Rakordimi midis DZHETB dhe DBFBNJ të Bashkisë Himare.

- Mungon rakordimi analitik periodike e vjetor dhe i dokumentuar midis sektorit të tarifave dhe taksave vendore dhe sektorit të kontabilitetit.

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore përdor për veprimtarinë e saj evidencën e vënë në dispozicion nga DZHETB (STTAL-ja), e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin Excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor *(në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin)* si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur efiçencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.

-Nuk ka gjurmë të rakordimeve periodike dhe vjetore midis DZFEBT dhe DBFBNJ, por janë mjaftuar me dërgimin me shkresë zyrtare të nivelit të realizimit të ardhurave vendore sipas kategorive.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar,; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "*Për sigurinë kibernetike*" neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "*Për bazat e të dhënave shtetërore"* Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të dhënave shtetërore" i ndryshuar; të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuara me Urdhrin e Ministrit të financave nr. 4, datë 26.01.2024, Kreu II, pika 2.4 dhe Kreu III, pika

-Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Komponentëve klientë ("Përdoruesit e sistemit") me kuadrin ligjor në fuqi.

Sistemi i përdorur nga Bashkia Himarë për administrimin e të ardhurave funksionon nëpërmjet përdoruesve (softëare) të instaluar në kompjuterët personalë të punonjësve të drejtorisë përkatëse. Nëpërmjet këtij sistemi realizohet regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave për subjektet e kategorisë biznes, duke përfshirë regjistrimin dhe modifikimin e tyre, përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, si dhe arkëtimin e të ardhurave nga vjelja e tyre. Sistemi gjeneron gjithashtu raporte që përdoren nga drejtimi për organizimin dhe monitorimin e punës lidhur me administrimin e bazës së të dhënave. Nga shqyrtimi i funksionimit të tij rezulton se disa elementë organizimit dhe administrimit të këtij sistemi nuk janë të formalizuara në mënyrë të plotë, siç janë rregullat e brendshme për funksionimin e sistemit, përshkrimi i proceseve të punës për përdoruesit, si dhe disa procedura që lidhen me administrimin e përdoruesve, monitorimin e të dhënave dhe rakordimet ndërmjet strukturave përkatëse. Në këto kushte, mënyra e administrimit të sistemit mbështetet kryesisht në praktikat e ndjekura nga strukturat përkatëse, ndërkohë që mungesa e një kuadri të detajuar rregullator dhe procedural mund të ndikojë në menaxhimin dhe kontrollin më të strukturuar të proceseve që lidhen me administrimin e të dhënave dhe raportimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26,neni 5...., neni 11,...;Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin

nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012, për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të dhënave shtetërore", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, kapitulli III, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot., datë 11.05.2022, neni 36**.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. D. B. ish/Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, F. D. Drejtor i Taksave, A. K. Përgjegjës sektori.

-Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Sa më sipër, në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, germa "c", ku përcaktohet që: "Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale". Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Himarë për vitin 2024-2025 paraqitet në Aneks.

Në Bashkinë Himarë për vitin 2024, totali i të ardhurave të planifikuara ishte 2,042,437,101 lekë.

Të ardhurat sipas kategorive tregojnë përformances e mëposhtme: Realizimi nga agjentët ishte 121%, ku nga një planifikim prej 18,800 mijë lekë, u arkëtuan 22,689 mijë lekë.

Të ardhura nga DRTRRSH: Realizimi ishte 160%, me 3,500 mijë lekë nga një planifikim prej 5,588 mijë lekë. Të ardhura: Realizimi paraqitet në 118%, me 11,823 mijë lekë nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë.

Të ardhura nga renta minerare: Realizimi ishte vetëm 5%, me 86 mijë lekë nga një planifikim prej 1,500 mijë lekë. Tatim mbi TAP: Realizimi ishte 137%, me 5,192 mijë lekë nga një planifikim prej 3,800 mijë lekë.

Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 479,505 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 441,277 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 92.03%.

Taksë pasurie e paluajtshme: Realizimi ishte 85.19%, me 44,000 mijë lekë nga një planifikim prej 37,484 mijë lekë.

Në përfundim, realizimi i të ardhurave për vitin 2024 në Bashkinë Himarë tregon përformances të lartë në disa kategori, por një realizim të ulët në kategori të tjera si renta minerare dhe tarif*a administrative.* Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të ardhurave. Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë Bashkisë Himarë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj. në dëm të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të

pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.
Kjo kërkon përmirësime në planifikim dhe mbledhje për vitet në vijim.
Në Bashkinë Himarë për vitin 2025, totali i të ardhurave të planifikuara ishte 3,153,212,mijë lekë. Të ardhurat sipas kategorive tregojnë përformances e mëposhtme: Realizimi nga agjentët ishte 121%, ku nga një planifikim prej 18,800 mijë lekë, u arkëtuan 22,689 mijë lekë.
Të ardhura nga DRTRRSH: Realizimi ishte 160%, me 3,500 mijë lekë nga një planifikim prej 5,588 mijë lekë.
Të ardhura: Realizimi paraqitet në 118%, me 11,823 mijë lekë nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë.
Të ardhura nga renta minerare: Realizimi ishte vetëm 5%, me 86 mijë lekë nga një planifikim prej 1,500 mijë lekë.
Tatim mbi TAP: Realizimi ishte 137%, me 5,192 mijë lekë nga një planifikim prej 3,800 mijë lekë.
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore; të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 479,505 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 441,277 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 92.03%.
Taksë pasurie e paluajtshme: Realizimi ishte 85.19%, me 44,000 mijë lekë nga një planifikim prej 37,484 mijë lekë**. Kjo situatë paraqet një ecuri pozitive të financave vendore dhe një rritje të kapaciteteve fiskale të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.**
Mbi Agjentët tatimor:
Për këtë kategori, realizimi i të ardhurave është 199%, ku nga një planifikim prej 19,000 mijë lekë janë realizuar 37,797 mijë lekë. Të ardhurat nga DRTRRSH u realizuan në masën 129% me 4,516 mijë lekë nga një planifikim prej 3,500 mijë lekë. Të ardhurat nga ASHK janë realizuar në masën 345% me 27,569 mijë lekë nga një planifikim prej 8,000 mijë lekë. Të ardhurat nga renta minerare u realizuan në masën 4% me 62 mijë lekë nga një planifikim prej 1,500 mijë lekë. Tatimi mbi TAP u realizua në masën 155% me 4,645 mijë lekë nga një planifikim prej 3,000 mijë lekë. Tatimi i thjeshtuar i fitimit shënoi një realizim prej 34% me 1,006 mijë lekë nga një planifikim prej 3,000 mijë lekë.
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë. Për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 181,000 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 131,450 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 73%. Taksa e pasurisë së paluajtshme ndërtesë u realizua në masën 77% me 26,975 mijë lekë nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë. Taksa për truall u realizua në masën 69% me 2,743 mijë lekë nga një planifikim prej 4,000 mijë lekë. Taksa për tokën bujqësore u realizua në masën 79% me 3,562 mijë lekë nga një planifikim prej 4,500 mijë lekë. Taksa e fjetjes në hotel u realizua në masën 67% me 10,024 mijë lekë nga një planifikim prej 15,000 mijë lekë. Tarifa për pastrimin u realizua në masën 56% me 39,149 mijë lekë nga një planifikim prej 70,000 mijë lekë. Tarifat për gjelbërimin dhe ndriçimin u realizuan në masën 99%, përkatësisht me 9,933 mijë lekë dhe 9,922 mijë lekë nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë për secilën.
Taksa e ndërtesës: Për vitin 2023, taksa e ndërtesës u realizua në masën 77%, ku nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë, u realizuan 26,975 mijë lekë, duke shënuar një diferencë prej 8,025 mijë lekë më pak.
Taksa e tokës bujqësore: Realizimi i kësaj takse ishte 79% me 3,562 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 4,500 mijë lekë, duke reflektuar një diferencë negative prej 938 mijë lekë.
Taksa e truallit: Kjo taksë u realizua në masën 69%, me 2,743 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 4,000 mijë lekë, duke rezultuar me një mosrealizim prej 1,257 mijë lekë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë: Realizimi i taksës ishte 98%, ku nga një planifikim prej 300,000 mijë lekë, janë arkëtuar 294,024 mijë lekë, duke shënuar një diferencë prej 5,976 mijë lekë.
Të ardhura nga qiraja: Realizimi për të ardhurat nga qiraja ishte në nivele të ndryshme, ku: Qiraja e trojeve ka realizuar 0%, me 0 lekë nga një planifikim prej 4,000 mijë lekë. Qiraja e ndërtesave gjithashtu ka realizuar 0%, me 0 lekë nga një planifikim prej 1,000 mijë lekë. Qiraja e kullotave ka tejkaluar pritshmërinë duke realizuar 121%, me 6,061 mijë lekë nga një planifikim prej 5,000 mijë lekë.
Tarifa për pastrimin: Realizimi i tarifës për pastrimin ishte 56%, ku nga një planifikim prej 70,000 mijë lekë, u arkëtuan 39,149 mijë lekë, duke shënuar një diferencë negative prej 30,851 mijë lekë.
Tarifa për ndriçimin: Kjo tarifë u realizua në masën 99%, me 9,922 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë, duke mbetur një diferencë prej vetëm 78 mijë lekë.
Tarifa për gjelbërimin: Realizimi për këtë tarifë ishte gjithashtu 99%, ku nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë, u arkëtuan 9,933 mijë lekë, duke lënë një diferencë minimale prej 67 mijë lekë.
Të ardhura nga tarifa për regjistrimin e automjeteve: Realizimi për këtë tarifë ishte 8.8% më i lartë se viti 2022, duke u arkëtuar 41 mijë lekë më shumë.
Të ardhura nga tarifa për kullotat: Realizimi për këtë tarifë ishte 54.2% më i ulët se viti 2022, me një diferencë prej 97 mijë lekë më pak nga pritshmërinë.
Të ardhura nga tarifa administrative: Kjo tarifë ka shënuar një realizim shumë të ulët, vetëm 17%, ku nga një planifikim prej 2,000 mijë lekë, janë arkëtuar vetëm 350 mijë lekë, duke shënuar një diferencë negative prej 1,650 mijë lekë.
Tarifa për hapësirën publike: Realizimi për këtë tarifë ishte 140%, ku nga një planifikim prej 80,000 mijë lekë, janë arkëtuar 112,114 mijë lekë, duke tejkaluar pritshmërinë me 32,114 mijë lekë.
Të ardhurat nga bashkëpunimi i DATTV me drejtoritë dhe strukturat e tjera. Për këtë kategori, realizimi ishte 103%, ku nga një planifikim prej 307,000 mijë lekë janë realizuar 315,820 mijë lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë u realizua në masën 98%, ndërsa tarifa për lejet e ndërtimit u realizua në masën 311%.
Të ardhurat e tjera: Për këtë kategori, realizimi ishte në masën 100%. Këtu përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti 2022 me një realizim prej 860,862 mijë lekë, transferat e pakushtëzuara në masën 143,281 mijë lekë dhe grantet specifike në masën 90,839 mijë lekë, përfshirë edhe 2,500 mijë lekë për mbrojtjen civile.
Agjentët tatimor ; viti 2024 Realizimi nga agjentët ishte 121%, ku nga një planifikim prej 18,800 mijë lekë, u arkëtuan 22,689 mijë lekë. Të ardhura nga DRTRRSH: Realizimi ishte 160%, me 3,500 mijë lekë nga një planifikim prej 5,588 mijë lekë. Të ardhura: Realizimi paraqitet në 118%, me 11,823 mijë lekë nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë. Të ardhura nga renta minerare: Realizimi ishte vetëm 5%, me 86 mijë lekë nga një planifikim prej 1,500 mijë lekë. Tatim mbi TAP, Realizimi ishte 137%, me 5,192 mijë lekë nga një planifikim prej 3,800 mijë lekë.
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 479,505 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 441,277 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 92.03%. Taksë pasurie e paluajtshme: Realizimi ishte 85.19%, me 44,000 mijë lekë nga një planifikim prej 37,484 mijë lekë.
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë. Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 479,505 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 441,277 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 92.03%. Taksë pasurie e paluajtshme: Realizimi ishte 85.19%, me 44,000 mijë lekë nga një planifikim prej 37,484 mijë lekë.

Taksa e ndërtesës: Për vitin 2024, taksa e ndërtesës u realizua në masën 85.68% , ku nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë, u realizuan 29,990 mijë lekë, duke shënuar një diferencë prej 5,010 mijë lekë më pak.

Taksa e tokës bujqësore: Realizimi i kësaj takse ishte 114.09% me 4,500 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 5,134 mijë lekë, duke reflektuar një diferencë pozitive prej 634 mijë lekë.
Taksa e truallit: Kjo taksë u realizua në masën 52.46%, me 4,500 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 2,361 mijë lekë, duke rezultuar me një mosrealizim prej 2,139 mijë lekë.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë: Realizimi i taksës ishte 98%, ku nga një planifikim prej 338,505 mijë lekë, janë arkëtuar 290,649 mijë lekë, duke shënuar një diferencë prej 47,856 mijë lekë.
Tarifa për pastrimin: Realizimi i tarifës për pastrimin ishte 48.96%, ku nga një planifikim prej 90,000 mijë lekë, u arkëtuan 44,067 mijë lekë, duke shënuar një diferencë negative prej 45,933 mijë lekë.
Tarifa për ndriçimin: Kjo tarifë u realizua në masën 114.99%, me 10,000 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 11,499 mijë lekë, duke mbetur një diferencë pozitive prej vetëm 1,499 mijë lekë.
Tarifa për gjelbërimin: Realizimi për këtë tarifë ishte gjithashtu 94.39%, ku nga një planifikim prej 10,000 mijë lekë, u arkëtuan 9,438 mijë lekë, duke lënë një diferencë minimale prej 562 mijë lekë.
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë. Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të administruara nga Bashkia Himarë për këtë kategori, totali i planifikuar ishte 1,355,876 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 2,945,875 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 217.27%.
Taksa e ndërtesës: Për vitin 2025, taksa e ndërtesës u realizua në masën 148.5%, ku nga një planifikim prej 44,000 mijë lekë, u realizuan 56,108 mijë lekë, duke shënuar një diferencë pozitive prej 12,108 mijë lekë më pak.

Taksa e tokës bujqësore: Realizimi i kësaj takse ishte 120.7% me 5,431 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 4,500 mijë lekë, duke reflektuar një diferencë pozitive prej 932 mijë lekë.
Taksa e truallit: Kjo taksë u realizua në masën 100%, me 6,382 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 6,000 mijë lekë, duke rezultuar me një mosrealizim prej 382 mijë lekë.
Taksa e ndikimit në infrastrukture: Realizimi i taksës ishte 188.79%, ku nga një planifikim prej 973,353mijë lekë, janë arkëtuar 1,837,578 mijë lekë, duke shënuar një diferencë prej 864,225 mijë lekë.
Tarifa për pastrimin: Realizimi i tarifës për pastrimin ishte 145.2% ku nga një planifikim prej 90,000 mijë lekë, u arkëtuan 119,919 mijë lekë, duke shënuar një diferencë negative prej 45,933 mijë lekë.
Tarifa për ndriçimin: Kjo tarifë u realizua në masën 107.1%%, me 11,000 mijë lekë të arkëtuara nga një planifikim prej 11,783 mijë lekë, duke mbetur një diferencë pozitive prej vetëm 783 mijë lekë.
Tarifa për gjelbërimin: Realizimi për këtë tarifë ishte gjithashtu 107.3%, ku nga një planifikim prej 11,000 mijë lekë, u arkëtuan 11,818 mijë lekë, duke lënë një diferencë minimale prej 818 mijë lekë.

Konkluzion ; Nga auditimi i realizimit të ardhurave për vitin 2024 rezultoi se të ardhurat e pushtetit vendor janë realizuar në masën 27% të planit vjetor, në vlerë 604,923,563 lekë, me një diferencë prej 1,437,513,538 lekë, më pak nga sa ishte planifikuar. Për mosrealizimin e planit të ardhurave, strukturat përgjegjëse nuk kanë hartuar analiza, raporte monitorimi apo

relacione shpjeguese mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë nivel realizimi, si dhe nuk kanë dokumentuar masat e marra për përmirësimin e arkëtimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 'Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore' dhe Ligjit nr. 10296/2010 'Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin', të ndryshuar, lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit, analizën e përformances financiare dhe menaxhimin e risqeve." *Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. D. B. Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z. B. K. Përgjegjës i Sektorit të administrimit të ardhurave dhe statistikave dhe z. T. D. Përgjegjës i Sektorit të vlerësimit dhe kontrollit të ardhurave. Për vitin 2023-2024.*
Ndërsa për Vitin 2025; rezultoi se të ardhurat e pushtetit vendor janë realizuar në masën 94.43% të planit vjetor, në vlerë **2,945,875,729.023** lekë, me një diferencë prej 207,336,387.98 lekë, nga sa ishte planifikuar, vlere e cila tregon një ulje të ndjeshme të debitorëve për periudhën dhe rritje të ardhurave për vitin 2025.

Grupi i auditimit duke i'u referuar analizimit të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave konstaton se:
Metodologjia e përdorur nga Bashkia Himarë për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk përputhet plotësisht me pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Evidenca e realizimit të ardhurave për vitin 2023,2024, nuk përmban informacion të plotë për të gjitha taksat dhe tarifat vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2024. Konkretisht, 58% e taksave dhe tarifave vendore nuk janë mbuluar plotësisht në evidencat e paraqitura. Sa më sipër, *"Evidenca e planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2024"* dhe *"Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat dhe tarifat vendore"* sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar, paraqiten me mangësi. Gjithashtu, mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e detyrimeve të prapambetura për gjithë taksat dhe tarifat vendore, duke krijuar pasaktësi në raportimin e situatës financiare. **Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:** Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, date 17.11.2016; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12. 2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime* në udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008, *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, *"Për përcaktimin e uniformi tetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore"* neni 12; pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV" pika 200, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"*, Rregullorja e Brendshme nr.115 datë 19.12.2022.
Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. D. B. Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z. B. K. Përgjegjës i Sektorit të administrimit të ardhurave dhe statistikave dhe z. T. D. Përgjegjës i Sektorit të vlerësimit dhe kontrollit të ardhurave.
-Të ardhurat e realizuara janë rritur me **2,050,695,887 lekë**, ose rreth **339% më shumë** se në vitin 2024.
Niveli i realizimit të planit është rritur nga **27% në 84.23%**, duke shënuar një rritje prej **57.23 %**
-Mosrealizimi i të ardhurave është ulur ndjeshëm nga **1,437,513,538 lekë, në 497,592,667 lekë**, duke treguar përmirësim të dukshëm në arkëtim dhe administrim.
-Për vitin 2025 të ardhurat e planifikuara në vlerën **3,153,212,117 lekë**, nga të cilat realizuar në masën **2,945,875,729.023** lekë ose **94.43%** e planit, duke rezultuar një mosrealizim në vlerën **207,336,388 lekë,** ose **7.04 %** krahasuar me planifikimin vjetor. Në krahasim me vitin 2024, në vitin 2025 konstatohet një **përmirësim i ndjeshëm i performancës së mbledhjes së të ardhurave**, si në vlerë ashtu edhe në përqindje realizimit.

Lloji i të ardhurës	Plani (lekë)	Realizimi (lekë)	Realizimi %
Të ardhura nga taksat	1,094,353,251	1,970,797,573	180.09%
Të ardhura nga tarifat	435,523,119	851,618,571	195.54%
Të ardhura të tjera	61,574,000	123,095,642	199.92%
Gjithsej	**3,153,212,117**	**2,945,875,729**	**94.43%**

Auditimit i ngarkesës me taksa dhe tarifa vjetore të subjekteve në sistemin e DATTV:
Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve tatimpaguese, me qëllim verifikimin e plotësimit të tyre me dokumentacionin ligjor mbështetës për vlerësimin e taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se në disa raste dosjet nuk janë të plota me dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e një vlerësimi të plotë tatimor. Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesit të faturimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, si dhe nga ndjekja e subjekteve debitore në sistemin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), u evidentua se nuk rezultojnë të dokumentuara në mënyrë të plotë akt-kontrolle nga sektori i terrenit për verifikimin e ndryshimeve në të dhënat e subjekteve apo për konfirmimin e të dhënave të deklaruara nga subjektet në QKB apo në sportelet e bashkisë. Në disa raste, vlerësimi i detyrimeve tatimore vjetore për ndryshime në të dhënat e subjekteve apo për ndërprerjen e faturimit nuk shoqërohet me evidenca të qarta të verifikimeve në terren ose me dokumentacion mbështetës nga regjistrat përkatës. Po ashtu, në sistemin elektronik nuk rezultojnë gjithmonë evidenca të dokumentuara mbi ndjekjen e plotë procedurave për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura nga subjektet debitore, ndërsa për subjektet që kanë adresa dytësore nuk evidentohet gjithmonë në mënyrë të plotë informacioni mbi numrin serial të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore për këto adresa. Këto elementë tregojnë nevojën për një dokumentim më të plotë procedurave të verifikimit dhe administrimit të dhënave të subjekteve tatimpaguese, në funksion të përmirësimit të saktësisë së vlerësimit dhe administrimit të ardhurave vendore

Konstatim: Metodologjia e përdorur nga Bashkia Himarë për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Evidenca e realizimit të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion për 60% të taksave/tarifave vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2023.
Sa më sipër *"Evidenca e planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2023"* dhe "*Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore"* sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar: nuk janë të plota. Mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore.

Konkretisht për vitin 2023 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Himarë, paraqitet në masën 73%, ose nga vlera 181,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar vlera 131,450 mijë lekë (*minus 49,550 mijë lekë*). Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me: Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 5, neni 1; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar.

Evidenca e planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2024 -2025, kanë një ndryshim në rritje të ardhurave ku për vitin 2024 të ardhurat janë realizuar në 90.2% dhe në vitin 2025 realizuar 180.09%.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023,2024,2025

Auditim mbi vlerësimin tatimor për subjektet që kanë status aktiv në regjistrin elektronik të DATTV në vitin 2023-2024-2025: Në Bashkinë Himarë, sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore *(DATTV)*, numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territor është si më poshtë:

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja Në fillim sipas 31.12.2023	Regjistrime të reja gjatë vitit 2024	Mbyllur aktivitete gjatë vitit 2024	Gjendja në fund të vitit 2024	Rregj Viti 2025
1	Biznesi vogël viti	800	141	78	863	1712
2	Biznes i madh viti	113	17	6	124	178
(1+2)	**Gjithsej viti 2023,2024,2025**	**913**	**158**	**84**	**987**	**1890**

Për vitin 2023,2024,2025 sipas të dhënave të administruara nga Bashkia Himarë, numri i subjekteve aktive në territorin e saj rezulton 913 subjekte, ku pjesën më të madhe e përbëjnë bizneset e vogla. Konkretisht, në fillim të vitit ishin të regjistruara 800 subjekte të vogla dhe 113 subjekte të mëdha. Gjatë vitit ushtrimor u regjistruan 158 subjekte të reja, nga të cilat 141 subjekte biznes i vogël dhe 17 subjekte biznes i madh, ndërsa 84 subjekte mbyllën aktivitetin e tyre, duke rezultuar në fund të vitit me 863 subjekte të vogla dhe 124 subjekte të mëdha aktive. Nga auditimi rezulton se të dhënat nuk janë të mbajtura nëpërmjet një sistemi të informatizuar çfarë e bën të pa qartë dhe jo të saktë numrin bizneseve, dhe për këtë arsye është e domosdoshme nevojën për përmirësimin e koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet strukturave përkatëse dhe për harmonizimin e të dhënave ndërmjet regjistrave të përdorur për administrimin e subjekteve dhe detyrimeve përkatëse ndaj buxhetit vendor.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me regjistrimin e subjekteve konstaton se:

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me*:* Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 5, neni 1; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar, neni 2 pika 13, pika 16 nenet 28-40, neni 42, neni 43 gërma d, neni 59; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, "*Për përcaktimin e uniformi tetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore*" neni 12; pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV" pika 200, "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*".

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z.D. B, Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z.B. K, Përgjegjës i Sektorit të administrimit të ardhurave dhe statistikave dhe z.T. D, Përgjegjës i Sektorit të vlerësimit dhe kontrollit të ardhurave.

Menaxhimi i borxhi

Subjektet Debitore.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik paraqitet si më poshtë:

Gjendja e debitorëve dhe arkëtimeve paraqitet si më poshtë për Biznesin në 000/ lekë

Nr.	Lloji Biznesit	Nr. Debitor Në fillim sipas 31.12.2024	Progresivi dt 31.12.2024	Nr. Subj viti 2025	Arketimi gjate 2025	Progresiv 31.12.2025
1	Debitor	1427	287,712	1890	116,429	171,283
(1+2)	**Gjithsej viti 2024-2025**	**1427**	**-**	**1890**	**-**	**-**

Konkluzion; Gjendja debitorë megjithëse gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 116,429 lekë nga debitorët, vlera e detyrimeve të prapambetura është ulur nga 287,712 mijë lekë në 171,283 mijë lekë (ose me 40.47%). Nga ana tjetër, numri i subjekteve debitorë është rritur nga 1,427 në 1,890 subjekte, çka tregon se pavarësisht uljes së vlerës totale të debisë, është zgjeruar numri i subjekteve me detyrime të papaguara. Kjo kërkon forcimin e masave për identifikimin, ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor. Vlera 54, 584 mijë lekë mbet pa arkëtuar për kategorinë biznes.

Pra, 40.47% e debisë së trashëguar është arkëtuar gjatë vitit 2025.

Nga analiza e treguesve të mësipërm rezulton se gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 116,429 lekë nga detyrimet debitorë të trashëguara, duke sjellë uljen e gjendjes debitorë nga 287,712 mijë lekë në 171,283 mijë lekë. Niveli i arkëtimit të debisë së trashëguar rezulton në masën 40.47%, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura vijon të mbetet e parketuar në fund të periudhës.

Në këto kushte, kërkohet vijimi i masave administrative për identifikimin, njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara, me qëllim rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave dhe uljen e stokut të debitorëve në vitet pasardhëse.

Taksat dhe Tarifat Familjare

Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Himarë ku familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore. Në tabelën e mëposhtme janë të identifikuar familjet debitorë: Numër familje debitorë

Viti 2023

Njësia A.	**Nr. Familje debitor**	**Detyrimi gjithsej deri me 31.12.2023**	**Arkëtuar deri 31.12.2023**	**Nr. Familje sipas fshatrave**	**Vlerë**	Detyrimi progresiv T.B 01.01.2023	Detyrimi funde 31.12.2023
Himarë	1980	**12,926,301**	**4,349,479**	1980	**8,576,821**	**13,722,508**	**59,760,313**
Horë Vranisht	611	**3,797,700**	**2,361,780**	**611**	**1,435,920**	**6,745,240**	**8,181,160**
Lukove	2714	**15,932,614**	**1,734,320**	**2714**	**14,198,294**	**21,085,517**	**35,283,811**
Totali	**5305**	**32,656,615**	**8,445,579**	**5305**	**24,211,035**	**41,553,265**	**103,225,284**

Burimi: DATTV Bashkia Himarë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi mbi planifikimin vjetor për kategorinë familjarë un konstatua se: viti 2024

Njësia A.	**Nr. Familje ebitor**	**Detyrimi gjithsej deri me 31.12.2024**	**Arkëtuar deri 31.12.2024**	**Nr. Familje sipas fshatrave**	**Vlera**	Detyrimi progresiv T.B 01.01.2024	Detyrimi funde 31.12.2024
Himarë	1980	18,182,657	9,330,856	2165	**8,851,801**	17,248,507	68,612,114
Horë Vranisht	431	**3,797,700**	**2,361,780**	**470**	**1,435,920**	**6,745,240**	**8,181,160**
Lukove	2613	**15,932,614**	**5,028,465**	2823	**10,904,149**	**23,693,529**	**46,187,960**
Totali		**37912971**	**16,721,101**	**5458**	**21,191,870**	**47,687,276**	**122,981,234**

Burimi: DATTV Bashkia Himarë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga verifikimi i të dhënave mbi administrimin e debitorëve të Taksës së Ndërtesës (TB) për kategorinë familjare në njësitë administrative të Bashkisë Himarë, rezulton se deri më datë 31.12.2024 detyrimi progresiv i kësaj takse paraqitet në vlerën 47,687,276 lekë, ndërsa detyrimi i mbartur në fund të periudhës ushtrimore arrin në vlerën 122,981,234 lekë.

Sipas të dhënave të administruara, numri i familjeve debitorë rezulton 5,024 familje, të shpërndara në njësitë administrative Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Nga detyrimi total

i evidentuar deri më 31.12.2024 në vlerën 37,912,971 lekë, janë arkëtuar 16,721,101 lekë, që përfaqëson një nivel arkëtimi prej afërsisht 44.1%, ndërsa pjesa e parketuar mbetet 21,191,870 lekë ose 55.9%.

Njësia Administrative Lukovë paraqet nivelin më të lartë detyrimeve të papaguara, me 2,613 familje debitorë dhe një vlerë të pashlyer prej 10,904,149 lekë, duke zënë rreth 51.5% të totalit të detyrimeve të papaguara. Më pas renditet Njësia Administrative Himarë me 8,851,801 lekë detyrime të papaguara dhe 1,980 familje debitorë, ndërsa Njësia Administrative Horë-Vranisht paraqet nivelin më të ulët të debisë me 1,435,920 lekë dhe 431 familje debitorë.

Konkluzion;Të dhënat tregojnë se, pavarësisht arkëtimeve të realizuara gjatë vitit 2024, niveli i detyrimeve të prapambetura vijon të mbetet i konsiderueshëm, duke ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave vendore dhe duke evidentuar nevojën për forcimin e masave administrative për identifikimin, ndjekjen dhe arkëtimin e debive të krijuara nga taksapaguesit familjarë. Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 1; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 1, neni 2 germat a, ç, neni 5 germat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47 , neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, nenet 60, 61, 62, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 ; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, neni 2 pika 13, pika 16 nenet 28-40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar.

Nga auditimi mbi planifikimin vjetor për kategorinë familjarë un konstatua se Viti 2025.

Njësia A.	Nr. Familje debitor	Detyrimi gjithsej deri me 31.12.2025	Arkëtuar deri 31.12.2025	Nr. Familje sipas fshatrave	Vlerë	Detyrimi progresiv T.B 01.01.2025	Detyrimi progresiv 31.12.2025
Himarë	1980	**18,906,715**	**8,860,657**	2165	**10,046,058**	20,783,167	**78,658,172**
Horë Vranisht	604	**3,797,700**	**1,946,760**	**838**	**1,850,940**	**9,632,440**	**10,163,390**
Lukove	2613	**15,932,614**	**5,028,465**	2823	**10,904,149**	**23,693,529**	**46,187,960**
Totali	**5197**	**38,637,029**	**15,835,882**	**5826**	**22,801,147**	**54,109,136**	**135,009,522**

Burimi: DATTV Bashkia Himarë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga analiza e të dhënave mbi administrimin e debitorëve të Taksës së Ndërtesës (TB) për familjarët, rezulton se deri më datë 31.12.2025 numri i familjeve debitorë është 5,197 familje, ndërsa numri total i familjeve të regjistruara në njësitë administrative Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht është 5,826 familje.

Detyrimi i evidentuar deri më 31.12.2025 rezulton në vlerën 38,637,029 lekë, nga i cili janë arkëtuar 15,835,882 lekë. Diferenca e parketuar ose debia e mbetur për t'u arkëtuar paraqitet në vlerën 22,801,147 lekë, që përbën rreth 59% të detyrimit total të evidentuar, ndërsa niveli i arkëtimit rezulton rreth 41%.

Detyrimi progresiv i taksapaguesve familjarë është në fillim të vitit 2025 në vlerën 54,109,136 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 arrin në 135,009,522 lekë, duke treguar një rritje të konsiderueshme të detyrimeve të akumuluara ndaj bashkisë.

Sipas njësive administrative:

Njësia Administrative Himarë paraqet 1,980 familje debitorë, me detyrime të papaguara në vlerën 10,046,058 lekë dhe një detyrim progresiv në fund të vitit prej 78,658,172 lekë.

Njësia Administrative Lukovë paraqet numrin më të lartë familjeve debitorë, 2,613 familje, me detyrime të pa arkëtuara në vlerën 10,904,149 lekë dhe detyrim progresiv në fund të vitit prej 46,187,960 lekë.
Njësia Administrative Horë-Vranisht paraqet 604 familje debitorë dhe detyrime të papaguara në vlerën 1,850,940 lekë, me detyrim progresiv në fund të vitit prej 10,163,390 lekë.
Nga krahasimi me vitin 2024 konstatohet se detyrimet progresive të Taksës së Ndërtesës janë rritur nga 122,981,234 lekë në 135,009,522 lekë, ose me 12,028,288 lekë, çka tregon se ritmet e arkëtimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të reduktuar stokun e debive të krijuara. Ky tregues evidenton nevojën për forcimin e masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe për përmirësimin e menaxhimit të bazës së të dhënave të taksapaguesve familjarë

Nga auditimi i aktrakordimit me thesarin u konstatua se:
1.Nga DATTV nuk kryhet evidentimi dhe rakordim në mënyrë analitike për pagesat e kryera nëpërmjet postës shqiptare sha por si vlerë në total.
2. Nga DATTV, për vitin 2023 nuk rezulton asnjë akt rakordim me agjentin ujësjellës sha Himarë.
3. Arkëtimet në Njësinë Horë Vranisht në vlerën 2.362 mijë lekë kryhen pranë zyrave të njësisë administrative. Nga DATTV nuk rezulton asnjë strukturë monitorim për administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe pse veprimet e kryera janë jashtë limiteve të lejuara për veprimet me arkë.
Për vitet 2024-2025, DATTV, ka kryer aktrakordimet më agjentin ujësjellës sha Himarë.
Masat e marra për uljen e borxhit
Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Himarë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Nuk janë ndërmarrë hapat sikurse janë të përcaktuara në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitetin e tyre pranë Bashkisë Himare për vitin 2023 , si dhe është kërkuar për 3 subjekte urdhër bllokimi i llogarive bankare. Nga auditimit konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë.
Për vitin 2024 janë përcjellë 94 njoftime ndaj bizneseve debitorë, duke krahasuar më numrin e debitorëve për vitin është një numër i vogël ndaj subjekteve debitorë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Taksave .
Në vitin 2025 , nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, janë përcjellë 574 njoftime ndaj subjekteve debitorë, 354 njoftime për bllokime llogarish si dhe 31 ekzekutime ndaj debitorëve.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet
Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Vlorë dh Sarandë, u auditua dokumentacioni për vitin 2023,2024 dhe 2025, i paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim

me Sektorin e Zhvillimit Urban. Në Bashkinë Himarë deri në 31.12.20225, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë. Nga DVASHK Vlorë dhe Sarandë, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësive Administrative të Bashkisë, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Himarë, nuk janë marrë të gjitha masat për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore objekt legalizimi. Në vijim paraqiten pasqyra sintetike e numrit të debitorëve dhe vlerës së tyre, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit-viti 2023

Periudha	Nr. I lejeve te legalizimit	Vlera e takses (leke) (0.5% e vl. Investimit)	Vlera e taksës e paguar	Vlera e debis për 2023, 2024 dhe 2025
Deri 31.12.2023	**45**	**2,813,306**	**756,595**	**2,056,711**
Deri 31.12.2024	**27**	**2,005,620**	**879,062**	**1,126,558**
Deri 31.12.2025	**25**	**1,300,985**	**468,336**	**832,649**
Shuma	**97**	**6,119,911**	**2,112,993**	**4,015,918**

Burimi: Bashkia Himare, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informal, u konstatua se në fund të vitit 2022 vlera debitorë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 697,435 lekë, e cila i përket 21 abonentëve.

Gjatë vitit 2023, janë faturuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë 45 abonentë me vlerë fature **2,813,306** lekë, nga ky detyrim është likuiduar vlera **756,595** lekë cila i përket 10 abonentëve. Debitorë të krijuar gjatë vitit 2024 janë 35 debitorë për vlerën **2,056,711** lekë.

Gjatë vitit 2024, janë faturuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë 27 abonentë me vlerë fature **2,005,620** lekë, nga ky detyrim është likuiduar vlera **879,595** lekë cila i përket 9 abonentëve. Debitorë të krijuar gjatë vitit 2024 janë 18 debitorë për vlerën **1,126,558** lekë.

Gjatë vitit 2025, janë faturuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë 25 abonentë me vlerë fature **1,300,985** lekë, nga ky detyrim është likuiduar vlera **468,336** lekë cila i përket 8 abonentëve. Debitorë të krijuar gjatë vitit 2025 janë 17 debitorë për vlerën **832,649** lekë

Debitorë progresivë për taksën e ndikimit në infrastrukturë janë 70 abonentë me vlerë detyrimi 4,015,918 lekë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore Bashkia Himarë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim". VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022, e ndryshuar me VKB nr. 57, datë 26.11.2025 "Për disa ndryshime në paketën fiskale të vitit 2022".

<u>Taksa mbi ndërtesën për vitin 2023 -2025 për kategorinë Biznes:</u>

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2023 për kategorinë Biznes në Bashkinë Himarë është përllogaritur bazuar në paketën fiskale të miratuar sipas VKB nr. 54, datë 25.11.2021, *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Himarë, penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023", e ndryshuar.* Përllogaritjet janë realizuar bazuar në çmimet referuese dhe shkallët e taksave të miratuara për njësitë

administrative përbërëse, të pasqyruara në tabelën më poshtë: Edhe për vitet 2024-2025 nuk ka ndryshuar përllogaritja çmimit të referencës.

Paketa fiskale 2023,2024,2025

-DATTV për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur me ndryshimin e të dhënave duhet të kërkojë pranë sektorit të kontrollit në terren kryerjen e verifikimit për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele, nëpërmjet Akt-Kontrolleve. Akt-Kontrollet e mbajtura nga sektori mbi kërkesat për ndryshime të dhënash nga subjektet tatimpagues shërbejnë për vlerësimin e detyrimit tatimor vjetor të subjektit nga sektori i vlerësimit pranë DATTV. Bazuar në të dhënat e evidencës së planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2023, taksa e pasurisë së paluajtshme ndërtesë rezulton të jetë realizuar në masën 77%. Nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë, është realizuar një vlerë prej 26,975 mijë lekë.

		Shkalla e taksës		Vlera për metër katror				Vlera për metër katror për njësitë që përdoren për zhvillim aktiviteti		
Njësitë Administrative Përkatëse	Çmimi referues i miratuar	Familje	Biznes	Shtëpi	Parkim i mbuluar	Parkim i Hapur	Banesa të privatizuar në 1993, vetëm për shtëpinë e parë	Njësi tregtimi dhe shërbimi	Parkim i mbuluar me bodrum	Parkim i hapur
Himarë	58,000	0.05%	0.23%	29	20	9	20	200	93	40
Lukovë	58,000	0.04%	0.23%	23	16	7	16	200	93	40
Horë Vranisht	58,000	0.35%	0.23%	20	14	6	14	200	93	40

Viti 2024

		Shkalla e taksës		Vlera për metër katror				Vlera për metër katror për njësitë që përdoren për zhvillim aktiviteti		
Njësitë Administrative Përkatëse	Çmimi referues i miratuar	Familje	Biznes	Shtëpi	Parkim i mbuluar	Parkim i Hapur	Banesa të privatizuar në 1993, vetëm për shtëpinë e parë	Njësi tregtimi dhe shërbimi	Parkim i mbuluar me bodrum	Parkim i hapur
Himarë	58,000	0.05%	0.23%	29	20	9	20	200	93	40
Lukovë	58,000	0.04%	0.23%	23	16	7	16	200	93	40
Horë Vranisht	58,000	0.35%	0.23%	20	14	6	14	200	93	40

Bazuar në të dhënat e evidencës së planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2024, taksa e pasurisë së paluajtshme ndërtesë rezulton të jetë realizuar në masën 85.6 %. Nga një planifikim prej 35,000 mijë lekë, është realizuar një vlerë prej 29,989 mijë lekë.

Viti 2025

		Shkalla e taksës		Vlera për metër katror				Vlera për metër katror për njësitë që përdoren për zhvillim aktiviteti		
Njësitë Administrative Përkatëse	Çmimi referues i miratuar	Familje	Biznes	Shtëpi	Parkim i mbuluar	Parkim i Hapur	Banesa të privatizuar në 1993, vetëm për shtëpinë e parë	Njësi tregtimi dhe shërbimi	Parkim i mbuluar me bodrum	Parkim i hapur
Himarë	58,000	0.05%	0.23%	29	20	9	20	200	93	40
Lukovë	58,000	0.04%	0.23%	23	16	7	16	200	93	40
Horë Vranisht	58,000	0.35%	0.23%	20	14	6	14	200	93	40

Bazuar në të dhënat e evidencës së planifikimit dhe realizimit të ardhurave për vitin 2025, taksa e pasurisë së paluajtshme ndërtesë rezulton të jetë realizuar në masën 127.52 %. Nga një planifikim prej 44,000 mijë lekë, është realizuar një vlerë prej 51,108 mijë lekë.

Nga tabelat e më sipërme dhe nga të dhënat e paraqitur rezulton se nga viti në vit është rritur vlera e arkëtimit për kategorinë Biznes në Bashkinë Himarë, e cila është përllogaritur bazuar në paketën fiskale.

Auditimi mbi "Subjektet e Tregtimit te karburanteve'' për vitin 2023-2025 për kategorinë "Biznes".

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Himarë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Himarë, që korrespondon me vitin 2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrfikës, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;

-Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)";

-Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Himarë dhe në Njësitë Administrative, na u vendosën në dispozicion 10 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon.

Nr.	Emri i Subjektit	Vlefshmëria e autorizimit	Adresa	NIPT	Vlera e Autorizimi	Vitet	Vlera
1	"V. P"	03.09.2019 - 02.09.2024	Shën Vasil, Sarandë	J.....N	200,000	3 vite	600,000
2	"O. O.'	08.03.2016 - 07.03.2021	Horë, Vranisht	L.....F	200,000	3vite	600,000
3	"G. 5" shpk	05.06.2015	Tërbaç	K.....F	200,000	3 vite	600,000
4	"D" shpk	20.11.2025 - 19.11.2026	Borsh	K.....E	200,000	3 vite	600,000
5	"M" shpk	04.07.2025 - 07.03.2026	Potam, Himarë	L.....A	200,000	2.5 vite	500,000
6	"H. P.2" shpk	07.02.2024 - 27.11.2029	Himarë	K.....H	200,000		
7	"H. P." shpk	01.02.2023 - 27.11.2023	Dhërmi, Himarë	K.....H	200,000	2 vite	400,000
8	"D. O." shpk	24.01.2014	Himarë	L.....G	200,000	3 vite	600,000
9	"D. O." shpk		Gjilekë, Dhërmi	L.....G	200,000	3 vite	600,000
10	"L. S" shpk	17.07.2021 - 16.07.2026	Shën Vasil, Sarandë	J.....S	200,000		
Totali							**4,500,000**

Nga auditimi i administrimit të taksës së licencimit për subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, rezultoi se 10 subjekte kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Himarë për periudha nga 2 deri në 3 vjet pa u pajisur me autorizimin/licencën përkatëse nga bashkia dhe pa kryer pagesën e taksës së licencimit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Mos identifikimi dhe mos ndjekja administrative e këtyre subjekteve nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Himarë ka sjellë mos arkëtimin e të ardhurave vendore në vlerën totale **4,500,000 lekë**, sipas përllogaritjes së kryer mbi bazën e tarifës vjetore prej 200,000 lekë për subjekt dhe periudhës së ushtrimit të aktivitetit pa autorizim.

Si pasojë, Bashkia Himarë nuk ka ushtruar në mënyrë efektive kompetencat e saj për administrimin e taksave vendore, duke mos siguruar regjistrimin, autorizimin dhe vjeljen e detyrimeve nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Veprime ne kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

Auditimi mbi *"Taksën e fjetjes në hotel"* për vitin 2023 *"Biznes"*

Nga analiza e të dhënave të administruara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) dhe Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore (DTTV) rezulton se në disa raste të dhënat mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e akomodimit nuk paraqiten të harmonizuara plotësisht ndërmjet këtyre dy strukturave. Konkretisht, janë evidentuar raste ku informacioni mbi dhomat e akomodimit të pasqyruara në dokumentacionin e lejeve të ndërtimit nuk rezulton i reflektuar në të njëjtën mënyrë në sistemin e administrimit të taksave vendore, çka mund të ndikojë në përllogaritjen e detyrimeve përkatëse për taksën e fjetjes. Po ashtu, nga shqyrtimi i procedurave të ndjekura për verifikimin e të dhënave të deklaruara nga subjektet rezulton se procesi i kontrollit dhe verifikimit në terren nuk paraqitet i dokumentuar në mënyrë të plotë për të gjitha rastet, gjë që mund të ndikojë në saktësinë e informacionit mbi numrin e dhomave të deklaruara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor konkretisht 2741 dhoma**.** Kjo situatë tregon nevojën për një koordinim më të mirë ndërmjet strukturave përkatëse të bashkisë, për përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e akomodimit, si dhe për forcimin e proceseve të verifikimit dhe monitorimit në funksion të administrimit më të plotë dhe të saktë të ardhurave nga taksa e fjetjes. Kjo situatë tregon që në vitet 2023-2024 nga strukturat përgjegjëse nuk është vlerësuar dhe identifikuar situata reale në fushën e hotelerisë, nga strukturat përkatëse të bashkisë, për përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e akomodimit, si dhe për forcimin e proceseve të verifikimit dhe monitorimit në funksion të administrimit më të plotë dhe të saktë të ardhurave nga taksa e fjetjes. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me: Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, neni 5, neni 1; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me: Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV" pika 200, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave".*

"Taksë e fjetjes në hotel"* për vitin 2024-2025*"Biznes"

Nga krahasimi i të dhënave për vitet 2024–2025 dhe verifikimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së të Ardhurave, rezultoi se në vitin 2024 ishin të regjistruara gjithsej 2,734 dhoma akomoduese, ndërsa në vitin 2025 numri i tyre arriti në 3,574 dhoma, duke shënuar një rritje prej 840 dhomash krahasuar me vitin paraardhës.

Nga verifikimet në terren u konstatua se një pjesë e këtyre dhomave kishin ushtruar aktivitet edhe në vitet e mëparshme, por nuk ishin evidentuar dhe regjistruar plotësisht në bazën e të dhënave të administrimit të taksës së fjetjes. Rritja e numrit të dhomave të identifikuara gjatë vitit 2025 tregon një përmirësim të procesit të evidentimit, kontrollit dhe administrimit të kësaj takse nga strukturat përgjegjëse.

Megjithatë, pavarësisht përmirësimit të evidentimit të bazës së taksueshme, në fund të vitit 2025 për taksën e fjetjes rezultuan debitorë 35 subjekte, me një detyrim të papaguar në vlerën **26,199,461** lekë, duke treguar nevojën për forcimin e masave të mbledhjes së detyrimeve dhe ndjekjen e debitorëve.

Nga auditimi i administrimit të ardhurave nga Taksa e Reklamës për vitet 2023–2025, rezultoi se për vitet 2023 dhe 2024 janë planifikuar të ardhura nga kjo taksë, por niveli i arkëtimeve ka qenë i ulët krahasuar me potencialin e pritshëm të ardhurave.

Për vitin 2024, të ardhurat nga Taksa e Reklamës janë planifikuar në vlerën 1,500 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 5,000 mijë lekë, ndërsa për vitin 2025 janë planifikuar 1,500 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 3,190 mijë lekë ose 212.7% të planit. Këta tregues evidentojnë një përmirësim të përformances së Bashkisë Himarë dhe të strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore në drejtim të identifikimit dhe mbledhjes së detyrimeve nga Taksa e Reklamës.

Megjithatë, auditimi konstatoi se administrimi i kësaj takse vijon të përballet me mangësi në identifikimin e plotë subjekteve që ushtrojnë aktivitet reklamues, evidentimin e elementëve reklamues në territor, si dhe përditësimin e vazhdueshëm të bazës së të dhënave. Këto mangësi ndikojnë në mosshfrytëzimin e plotë potencialit të ardhurave dhe krijojnë risk për mos arkëtimin e detyrimeve që i takojnë buxhetit vendor.

Në këtë kuadër, përmirësimi i koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, kryerja periodike e verifikimeve në terren dhe përditësimi i evidencave për subjektet aktive do të mundësonin administrim më të plotë bazës së taksueshme dhe ndjekje më efektive të detyrimeve përkatëse.

Veprimet e më sipërme nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, veçanërisht nenet 20–25 të Kreut IV; si dhe Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, lidhur me evidentimin, administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. D. B. Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z. B. K. Përgjegjës i Sektorit të administrimit të ardhurave dhe statistikave dhe z. T. D. Përgjegjës i Sektorit të vlerësimit dhe kontrollit të ardhurave F. D., A. K. Përgjegjës Sektori. Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi këtë drejtim të auditimit.

3. Auditim mbi llogaritë vjetore për vitin 2025. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 202025 nga njësia shpenzuese "Bashkia Himarë " për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Himarë për vitin 2025 ka hartuar mbi afatin e përcaktuar në dispozitat ligjore Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete si me poshtë:

1. Aparati Bashkia Himarë
2. Ndërmarrja e Shërbimeve Publik

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Mat për vitin ushtrimor 2025 me shkresë përcjellëse nr.prot.1113, datë 24.03.2026. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Himarë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

➢ *Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit*

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"dhe nuk ka një program financiar, i cili do të shmangte pasaktësitë
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.

Konkluzion: Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet

vërtetuese. Pra në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit nuk ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", ku ndër të tjera theksohet se: "....- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.- Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme"* Kreu III,

- pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", **nënpika 28** *"Çdo njësi e qeverisjes se përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore.*

- pika 3.2 "Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme" në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon:* ***Nënpika 43.*** *Fillimisht, njësit e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore.* ***Nënpika 44****. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore" në llogarinë 12 "Rezultat i mbartur".* ***Nënpika 45****. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitin 2025

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim
Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,
Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës
Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
Plotësia: Nuk mund të jepet një konkluzion nëse të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk dihet nëse janë të paraqitura të plota në bilanc, pasi mungojnë të dhënat analitike dhe shpjegimet përkatëse për to
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme, por të papërshkruara, si dhe nuk janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".
Nga testi kontrollit për vitet 2025 në lidhje me:
Rregullaritetin i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:
Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit për pagesat e kopshteve dhe çerdheve.gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.
Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve*

në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin

Konkluzion: Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit për veprimet ekonomike nëpërmjet bankës rezulton se kontabilizimi i është bërë në mënyrë të pa plotë vetëm sipas natyrës së shpenzimeve dhe jo sipas destinacionit, duke sjellë pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të transaksioneve financiare të kryera me bankë. Po kështu mungojnë librat ditarë të mbajtjes së kontabilitetit gjatë vitit ushtrimor për veprimet me magazinën, veprimet për blerjet e aktive afagjata, veprimet me pagat, libri i veprimeve të ndryshme dhe në fund të vitit ushtrimor të bëhej rakordimi i llogarive që preken si dhe prerja e artikujve kontabël të pasqyruara në librin e madh, të cilat finalizohen në pasqyrat financiare. Mosmbatja e kontabilitetit në mënyrë të plotë e të saktë në përputhje me parimet e kontabilitetit sjell pasiguri dhe nuk sjell besueshmëri se si kanë rrjedhur vlerat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrat anekse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II pikat 15-23, Kreu III.

- *Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.*

Totali i Aktivit për vitin 2025 është në vlerën 30,748,982,535 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike, paraqitet në Aneks

A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatshkurtra" në aktiv të bilancit** paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **3,947,102,041** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,845,769,518 lekë.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën **3,623,137,621** lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën VI " Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOŴ) sipas metodës direkte" të paraqitur në Aneks.

Konkluzion:
Nga auditimi i pasqyrës së flukseve monetare rezulton se shumat në llogaritë sintetikë dhe anilitikë nuk janë të sakta, pasi janë keqklasifikuar, pavarësisht se seksioni "Teprica e likuiditeteve" si në çelje në shumën 1,522,178,282 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2025 në shumën 3,623,137,621 lekë është sipas aktrakordimit me thesarin. Kjo ka ndodhur sepse veprimet në debi dhe në kredi të llogarisë 520"Disponibilitete në Thesar" sa i përket shumave të transaksioneve nuk janë të sakta, kështu:

a. Tek rubrika I "Veprimtaritë e shfrytëzimit" seksioni 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" paraqitet në shumën 142,211,624 lekë, kur duhet të ishte 197,010,542 lekë sipas aktrakordimit me thesarin. Po kështu kjo shumë nuk rakordon me gjendjen e llogarive analitike 7200-7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)" në pasqyrën e performancës që paraqitet në shumën 304,161,341 lekë.

- ✓ Seksioni 2 "Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor" paraqitet në shumën 3,065,758,069 lekë, ku përfshihet gjendja e llogarisë analitike "Të hyra nga tatimet" paraqitet në shumën 3,037,612,123 lekë, sipas pasqyrës së performancës llog.70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet" paraqiten në shumën 2,788,598,682 lekë. Ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin totali i të ardhurave të arkëtuara është në shumën 2,945,875,792 lekë
- ✓ Seksioni 3 "Pagesa për detyrime e shpenzime korente" paraqitet në vlerën 528,074,914 lekë, së cilës duke i zbritur pagesat për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 507,663,542 lekë, ndërkohë sipas aktrakordimit me thesarin shpenzimet faktike për pagesat për detyrimet e vitit ushtrimor dhe vitet e kaluara janë në vlerën 544,406,691 lekë.

b. Tek rubrika e II " Veprimtaritë e investimeve" e cila paraqitet në mënyrë të gabuar në vlerën -578,935,440 lekë, kur duhet të ishte në vlerën +51,162,377 lekë, sepse është plotësuar vetëm llogaria analitike "Pagesa për detyrimet e investimeve të vitit ushtrimor" e cila paraqitet në vlerën 578,935,440 lekë, ndërkohë sipas aktrakordimin me thesarin për shpenzimet është në vlerën -542,182,392 lekë, pra me një diferencë prej 36,753,048 lekë. Ndërsa llogaria analitike "Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale" nuk është plotësuar dhe paraqitet në vlerën 0 lekë, kur duhet të ishte në vlerën +593,344,769 lekë sipas aktrakordimit me thesarin.

c. Tek rubrika III "Transferta të tjera" paraqitet në shumën 0 lekë, pasi llogaritë analitike paraqiten të pa plotësuara si: "Derdhje e Transferime të të Ardhurave ne Buxhet" "Transferime në buxhet të fondeve të pa përdorura", "Lëvizje të brendshme e transferta të tjera", duke mos u përputhur me aktrakordimin me thesarin.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kap. 3.5 i ndryshuar me UMF nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 24.

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 15,000,276 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 12,664,015 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej -2,336,261 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- *Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 3,883,079 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,546,818 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 2,336,261 lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2024.

- *Gjendja e llogarisë 32* "*Inventari i imët"* paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në të njëjtën vlerë prej 11,117,197 lekë, pra pa ndryshime të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2025.

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **308,964,144** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **310,927,221** lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm.

- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 287,712,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën **287,712,000** lekë.

Konkluzion: Teprica e ***llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"*** në mbyllje të vitit 2025 ***paraqitet*** në vlerën 287,712,000 lekë, vlerë e cila nuk është e saktë dhe e besueshme, pasi edhe në fund të vitit 2024 paraqitet në të njëjtën vlerë. Kjo vlerë nuk dihet se çfarë përfaqëson, pasi mungon analiza e saj sipas kategorive të debitorëve, duke sjellë mospasqyrimin e plotë të drejtave të konstatuara në pasqyrat financiare. Referuar të dhënave të DTTV gjatë vitit 2025 është krijuar një debi prej 14,864,937 lekë nëse është reale, vetëm nga taksatpagusit familjarë për taksa e tarifa vendore (12,028,288lekë), individë për taksën në infrastrukturë për legalizimet (832,649 lekë) dhe subjektet për tarifën vjetore të autorizimit për lejimin e aktivitetit për tregtim karburantesh (2,000,000 lekë), ndërsa për debitorët taksapagues të biznesit nuk ka të dhëna. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. III, kap.3.1, pika 32, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve" paragrafi "Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve" fq 28-30.

- ***Teprica e llogarisë 4342*** **"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"** në aktiv të pasqyrës të pozicionit financiar paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën **21,252,144** lekë, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Kjo gjendje rakordon me shumën e llogarive kundërparti në pasivin e bilancit: llog.42"Detyrime ndaj personelit" për vlerën 14,726,924 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 1,538,629 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 4,384,334 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 602,257 lekë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **26,801,880,494** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **26,303,103,877** lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 25,154,389,196 lekë, pra nuk ka shtesa dhe pakësime. AAGJM janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 202 ***"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën 56,588,213 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 56,588,213 lekë, të cilat rakordojnë me llogarinë anloge në Formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerë neto)". Ndërsa në Formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje 2024 dhe në mbyllje 2024 janë në vlerën 182,687,308 lekë .

Konkluzion: Për vlerën e mbetur në fund të vitit 2025 prej 56,588,213 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* mungon analiza për të përcaktuar se çfarë projekt-studimesh janë dhe kujt investime të pakryera ose të kryera u përkasin. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% për vitin 2025, duke sjellë mbivlerësimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2024 dhe 2025.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në 24,114,673,823 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej 24,194,832,646 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 25,154,389,196 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025, në vlerën 25,154,389,196 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 22,620,865,178 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 22,620,865,178 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2025 është 22,620,865,178 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 22,620,865,178 lekë dhe nuk ka asnjë ndryshim nga viti në vit. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 "Toka, troje terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative.

- Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 ne shumen prej 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 ne vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën prej 0 lekë. Kjo gjendje tregon se pasuritë e paluajtshme të transferuara nga qeveria qendrore me VKM parcelat të fondit pyjor-kullosor që shtrihen në territorin e Bashkisë Himarë nuk janë vlerësuar e përfshirë në kontabilitet.

- Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,119,974,529 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,178,920,557 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,528,215,355 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,528,215,355 lekë. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative.

- Gjendja e llogarisë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 336,615,898 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në 354,332,524 lekë. Gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 915,522,382 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 915,522,382 lekë. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative.

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **7,831,712** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **8,243,907** lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 ne vlerën **23,747,353** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **23,747,353** lekë. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative.

- ***Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"*** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 21,597,442 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 22,734,150 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 44,402,639 dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 44,402,639 lekë. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 215 "Mjete Transporti" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative.

- ***Gjendja e llogarisë 218 "Inventar ekonomik"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën neto prej **7,789,064** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën neto **9,736,330** lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **21,636,289** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **21,636,289** lekë. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 218 "Inventar ekonomik" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të gjithë aktivet e këtij lloji për të gjitha njësitë administrative

Konkluzion: Nga auditimi i aktiveve afatgjata jo materiale dhe materiale rezultoi se gjendjet (kosto historike) e llogarive të këtyre grupaktivesh janë të pa analizuara, nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik për to, si për: tepricën e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 182,687,308 lekë, tepricën e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 22,620,865,178 lekë; tepricën e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,528,215,355 lekë; tepricën e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 915,522,382 lekë; tepricën e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"* në vlerën 23,747,353 lekë; tepricën e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 44,402,639 lekë; tepricën e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 21,636,289lekë. Kjo situatë ndikon në besueshmërinë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Mungon regjistri historik format i miratuar për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur
Këto veprime janë në kundërshtim UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli III, i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2025 paraqiten në Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata" të PF paraqitet në Aneks.

- ***Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale*** paraqitet në vlerën **126,099,095** lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

- **Gjendja e llogarisë *26 " Pjesëmarrje në kapitalin e vet"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **231,278,350** lekë, vlerë e cila është trashëguar që nga viti 2022, për të cilën nuk ka informacion se çfarë investimi kapital është kryer.
Konkluzion: Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria sintetike 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën

2,399,340,108 lekë, vlerë për të cilën mungon analiza kontabël. Kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar ose të pa marra në dorëzim. Mungesa një analize të gjendjeve të llogarive të investimeve për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi 1.

- ***Gjendja e llog. 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **75,620,853** lekë, vlerë për të cilën mungon analiza kontabël.

- ***Gjendja e llog. 231"Investime për aktive afatgjata materiale"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,744,783,815 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 në vlerën 2,323,719,255 lekë, vlerë për të cilën mungon analiza kontabël. Pra kemi një rritje të investimeve në shumën 578,935,440 lekë. Kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar.
Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 2,399,340,108 lekë, ndërsa llogaritë kundërparti të saj në rubrikën në pasiv "Fondin e konsoliduar" paraqiten: llog. 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në shumën 1,116,934,390 lekë, llog. 106 *"Teprica e granteve kapitale të huaja"* në shumën 0 lekë, llog.115 "*Nga fondet e veta të investimeve"* në shumën 1,282,405,718 lekë, pra llogaritë e shpenzimeve për investime kuadrojnë me llogaritë e burimeve të financimit. Gjithashtu llogaritë llog. 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në shumën 1,116,934,390 lekë, llog. 106 *"Teprica e granteve kapitale të huaja"* në shumën 0 lekë, llog.115 "*Nga fondet e veta të investimeve"* në shumën 1,282,405,718 lekë,kuadrojnë me llogaritë analoge në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të investimeve si në çelje dhe në mbyllje të vitit ushtrimor.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **381,887,231** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- ***Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogaritje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë.

- ***Teprica e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 14,726,924 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2026
- ***Teprica e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën kontabël 1,538,629 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2026.
- ***Teprica e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 4,384,334 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- ***Teprica e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2025 është në vlerën kontabël 602,257 lekë.

- ***Teprica e llogarisë* 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"** përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 72,923,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 65,188,513 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Vlore.

Konkluzion: ***Teprica e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 3,911,400 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë. Sipas raportit vjetor të vetëvlerësimit të Bashkisë Himarë për situatën e gjendjes financiare në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura paraqiten në shumën 1,974,600 lekë për fatura të palikujduara për shpenzime për investime. Sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Financave për detyrimet e prapambetura për vitin 2025 për gjithë njësitë shpenzuese rezulton se Bashkia Himarë ka detyrime të prapambetura në shumën 2,000,000 lekë. Ndërsa referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit sipas sistemit "accrual" detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në fund të vitit 2025 rezultojnë në shumën 48,492,482 lekë. Pra mungon një evidentim i saktë dhe i plotë i detajuar i detyrimeve që ka bashkia ndaj të tretëve në fund të periudhës ushtrimore. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II pika 8, 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III, pika 42, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, pika 3.5.

- Teprica e llogarisë 4341 ***"Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë.

- Teprica e llogarisë 475 ***"Të ardhura për t'u regjistruar në vitet pasardhëse"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 287,712,000 lekë dhe rakordon me tepricën e llogarisë kundërparti në aktiv 468 "Debitorë të ndryshëm".

- Rubrika D: Fondi i Konsoliduar

Nr. rreshti	**Referenca llogarive**	**Emërtimi i llogarive**	**Ushtrimi i mbyllur 2025**	**Ushtrimi paardhës 2024**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**30,367,095,304**	**27,772,757,661**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,186,740,733	1,264,563,295
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	3,550,214,534	1,456,989,769
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	1,282,405,718	1,127,532,439
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	1,116,934,390	692,872,229
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	-	-
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	23,230,799,929	23,230,799,929
107		Te Tjera	-	-

- Rubrika D: Fondi i Konsoliduar paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 30,367,095,304 lekë, e cila përbëhet nga:

- **Teprica e llogarisë 101** ***"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"*** në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 1,186,740,733 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 1,264,563,295 lekë, vlera të paraqitura saktë.

- **Teprica e llogarisë 105** ***"Teprica e granteve kapitale të brendshme"*** në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 1,116,934,390 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 692,872,229 lekë

- **Teprica e llogarisë 115** ***"Nga fondet e veta të investimeve"*** në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë plus gjendjen e llogarisë 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në vlerën 1,282,405,718lekë nuk rakordojnë me tepricën e llogarisë kundërparti 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 1,127,532,439 lekë**.**

- Teprica e llogarisë 85 ***"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"*** në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 3,550,214,534 lekë, e cila rakordon me llogarinë analoge në pasqyrën e përformancës.

Konkluzion: Teprica e llogarisë **109** ***"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata" si*** në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 23,230,799,929 lekë,

vlerë e cila është e trashëguar me vite dhe mungon informacioni për të. Llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i AAGJ" preket nga procesi i rivlerësimit që lidhet me daljen e një VKM për rivlerësimin e Aktiveve afatgjata, materiale dhe jo materiale dhe në varësi të efektit që jep rivlerësimi (shtesë ose pakësim në vlerën e aktiveve). Veprimi kontabël që kryhet është: Kreditohet ose debitohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i AAGJ" dhe në kundërparti përkatësisht debitohen ose kreditohen llogaritë e grupit 20 e 21 të AAGJ. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike, pasqyrë ë cila paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarive të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 4,571,001,936 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Vlore paraqitet më poshtë:
Konkluzion: Në pasqyrën e performancës teprica e llogarisë sintetike ***70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"*** paraqitet në vlerën 2,788,598,682 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin të ardhurat nga taksat dhe tatimet janë në shumën 2,945,875,792 lekë, pra me një deviacion prej 157,277,110 lekë. Nuk janë plotësuar llogaritë analitike të ardhurave tatimore dhe jo tatimore. Vlera e të ardhurave tatimore është paraqitur në mënyrë të gabuar në tepricën e llogarisë 703 *"Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit"* dhe në tepricën e llogarisë analitike 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie".*
Konkluzion: Teprica e llogarisë sintetike të fondeve ***72 "Grante Korente"*** është në vlerën prej 325,413,485 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me aktrakordimin me thesarin dhe përbëhet nga teprica e llogarisë analitike *7200* "*Nga buxheti për NJQP (Qendrore)"* në vlerën 55,147,900 lekë dhe teprica e llogarisë analitike *7201* "*Nga buxheti për NJQP (Vendore)"* në vlerën 249,013,441 lekë, si dhe llog.7206 **"***Financim i pritshëm* në vlerën 21,252,144 lekë. Gjendja e llogarive analitike 7200-7201 *"Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)"* paraqitet në mënyrë të gabuar në shumën 304,161,341 lekë, pasi sipas aktrakordimit me thesarin është 197,010,542 lekë.

- llog.7206 "*Financim i pritshëm* në vlerën 21,252,144 lekë vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*në formatin nr.1 "Pasqyra e pozicionit financiar", pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara**.**

Konkluzion: Nga auditimi në pasqyrën e performancës rezulton se në të ardhurat e vitit ushtrimor 2025 është përfshirë gjendja e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" në shumën 1,456,989,769 lekë që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës të pasqyruar një herë në atë vit dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën **1,020,787,402** lekë paraqitet më poshtë:
Konkluzion: Nga analiza e shpenzimeve në pasqyrën e përformancës rezulton se:
-Teprica e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 212,804,197 lekë, por nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e konstatuara në fakt janë në vlerën 210,947,910 lekë, pra 1,856,287 lekë më shumë. Kjo vlerë e përllogaritur ka rezultuar nga shpenzimet për paga e shpërblime të paguara sipas aktrakordimit me thesarin në shumën 208,903,451 lekë, duke zbritur pagat e dhjetorit të vitit 2024 në shumën 12,682,465 lekë të paguara në janar të vitit 2025 dhe duke shtuar pagat e dhjetorit të vitit 2025 në shumën 14,726,924 lekë

- Teprica e llogarisë *601 "Kontribute për sigurime"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 35,161,047 lekë, por nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e konstatuara në fakt janë në vlerën 33,334,597 lekë, pra 1,826,450 lekë më shumë. Kjo vlerë e përllogaritur ka rezultuar nga shpenzimet për kontribute e tatime të paguara sipas aktrakordimit me thesarin në shumën 34,629,978 lekë, duke zbritur detyrimet e dhjetorit të vitit 2024 në shumën 1,417,005 lekë të paguara në janar të vitit 2025 dhe duke shtuar detyrimet e dhjetorit të vitit 2025 për kontribute e tatime në shumën 14,726,924 lekë.
- Teprica e llogarisë *602 "Blerje mallra e shërbime"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 175,366,648 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin shpenzimet vjetore për mallra e shërbime janë në shumën 230,472,287 lekë, zbresim detyrimet e papaguara në fund të vitit 2024 në shumën 3,911,400 lekë, shtojmë detyrimet ndaj të tretëvë në fund të vitit 2025 që janë në shumën 0 lekë, vlera e përllogaritur është 226,560,887 lekë, pra paraqitur 51,194,239 lekë më pak.
- Teprica e llogarisë së fondeve *604 "Transferime korente te brendshme"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 17,783,945 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 5,816,345 lekë, pra paraqitur 11,967,600 lekë më shumë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II.

- Gjendja e llogarisë së fondeve *606 "Transferime për buxhetet familjare e Individe"* paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 64,584,628 e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë *63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në pasqyrën e pozicionit financiar, ku për vitin 2025 është në vlerën -2,336,261 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi në pasqyrën e performancës rezulton se gjendja e seksionit "Shpenzime të tjera" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në shumën 517,423,198 lekë, vlerë për të cilën nuk ka analizë dhe nuk ka informacion nga çfarë ka rezultuar kjo vlerë. Në këtë llogari nga pikëpamja e shpenzimeve përfshihen operacionet e korrigjimit të rezultatit si: teprica e llogarisë 831 "Caktim të ardhurash të funksionimit për investime", teprica e llogarisë 842 "Derdhje e transferime të ardhurave në buxhet", teprica e llogarisë 8421 "Derdhje ne buxhet te të ardhurave të papërdorura".
Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025, rrjedhimisht pozicionin financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, duke mos dhënë siguri edhe mbi tepricat e transaksioneve mbi të cilat është përgatitur pasqyra e flukseve apo pasqyra e pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi 1,I ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05, datë 21.02.2022, pika 4 "Shpenzimet të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e Qeverisë së Përgjithshme (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6,7 dhe 8).

Për vitin 2025 totali i të ardhurave është në vlerën 4,571,001,936 lekë dhe **totali shpenzimeve** është 1,020,787,402 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 3,550,214,534 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit" në pasqyrën e pozicionit financiar.

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"
- Gjendjet e llogarive në Formatin nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit" rakordojnë më llogaritë analoge që paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" dhe në Formati nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOŴ). Për pjesën e inventarizuar

Inventarizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:
Për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2025 është nxjerrë urdhri i titullarit me nr.639, datë 21.10.2025 me shkresën nr.prot. 7932, datë 21.10.2025 "Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve në Bashkinë Himarë për vitin 2025". Në bazë të këtij urdhri është përcaktuar komisioni i inventarizimit prej 7 punonjësish me kryetar zj.R. Z. dhe anëtarë: K. Dh., M. H., K. Ç., A. Dh., E. N., E. H. Në urdhrin e inventarizimit ndër të tjera është përcaktuar se *"....Komisioni ngarkohet për kryerjen e vlerësimit të aktiveve dhe të paraqesë pranë Drejtorisë së Financës rezultatet përfundimtarë të inventarizimit në raport narativ brenda datës 15.12.2025. Sektori i raportimit financiar pranë Drejtorisë së Financës ngarkohet për nxjerrjen e gjendjes kontabël. Rezultati i administruar nga komisioni i inventarizimit të pasqyrohet në bilancin vjetor për periudhën janar-dhjetor. Inventari përfundon në 29.12.2025. Gjatë periudhës së inventarizimit komisioni sipas përcaktimeve të pikës 2, ngarkohet të raportojë pranë Drejtorisë së Financës dhe Kabinetit çdo 15 ditë....."*
Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, procesi i inventarizimit vazhdon edhe pse sipas urdhrit duhej të mbaronte me datë 29.12.2025, pasi nuk është kryer akoma procesi i inventarizimit për paisje dhe mobilje zyrash në njësitë administrative Horë-Vranisht dhe Himarë, inventari i magazinës për grupaktivet e llog. 31 "materiale"dhe llog.32 "inventar imët", të grupaktiveve të llog.215 "mjete transporti", llog.214 "Instalime teknike, makineri dhe paisje". Për inventarizimet e kryera nga komisioni i inventarizimit ka hartuar fletët e inventarëve të grupaktiveve të llogarisë 218 "inventar ekonomik" sipas gjendjes kontabël dhe fizike për zyrat në Aparatin e Bashkisë dhe për Njësinë Administrative Lukovë, 13 shkolla, 1 kopësht**.** Fletët e inventarëve për e inventarizuar janë mbajtur në nivel grupartikujsh dhe jo në nivel artikulli dhe nuk ka aktive të vlerësuara jashtë përdorimi. Për procesin e inventarizimit në objektet e kryera nga komisioni i inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale me përgjegjësin material. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"pikat 73-106.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: zj. B. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartueses të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2025.
Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi këtë drejtim të auditimit.

Pika 4.Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëma nga auditimi i mëparshëm.

1. **Hartimi i programit (Planit të veprimit) dhe respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit".**

1.1. Auditimi i fundit në Bashkinë Himarë është kryer në vitin 2024 për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 874/14 prot., datë 17.05.2024. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 22 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 5 masa shpërblim dëmi në vlerën 9,393,969.24 lekë, pranuar nga subjekti;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara në vlerën, pranuar nga subjekti;
- 13 masa të ardhura të munguara në vlerën 581,911,482 lekë, pranuar nga subjekti;
- 11 masa disiplinore, pranuar nga subjekti;

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	21	21	-	-	-	21
Shpërblim dëmi	5	5	-	-	-	5
EEE	2	2	-	-	-	2
Te Ardhura te Munguara	13	13	-	6	-	7
Masa Disiplinore	11	11	-	-	-	11
Totali	**52**	**52**	**-**	**6**	**-**	**46**

1.2. Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", neni 15, germa j, Bashkia Himarë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Himarë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 874/14 prot., datë 17.05.2024 ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 315/26 prot., datë 01.07.2024 protokolluar në KLSH me nr. 874/15, datë 09.05.2024 ku pasqyrohen veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse.

1.3. Referuar shkresës nr. 874/14 prot., datë 17.05.2024, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", neni 30, pika 2, "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna". Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Himarë nuk ka kthyer përgjigje në KLSh ku të pasqyrohen veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse.

1.4. Nga verifikimi rezulton se Bashkia Himarë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 874/14 prot., datë 17.05.2024, por nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audituesë të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

1.5. **Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar dhe pjesërisht të zbatuar**

Me shkresën nr. 315/25 prot., datë 12.06.2024 është miratuar Urdhri nr. 236, datë 12.06.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e progamit/planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit".

A. <u>MASA ORGANIZATIVE.</u>

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me komponentët e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit u konstatua që:

Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Himarë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.
Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
Në Bashkinë Himarë nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.
Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion "Koordinatori i Riskut", ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.
Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).
Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur si strukturë, duke sjellë mungesën e një elementi që luan rol të rëndësishëm në funksionin e monitorimit e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, 12/d,19,20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MF nr.4 datë 10.01.2020, Kap. II 2.4.1 dhe 2.4.2; Kap. III, pika 3.5; Kap. IV pika 4.1.11 dhe 4.1.12; Kap. VI pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kap. VII pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 6-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi, rezulton se planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (*të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti*) ka vlerën **1,341,496 mijë lekë**, ndërsa realizimi **539,935 mijë lekë**, ose në masën 40%, ku zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **127,825 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **109,436 mijë lekë**, ose në masën 86%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 79%.
Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **297,892 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **158,988 mijë lekë**, ose në masën 53.%.
Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **827,787 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **240,407 mijë lekë,** ose në masën 29%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Himarë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Neni 46 "Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 14-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe drejtoritë e tjera të Bashkisë Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, Nga ana e Bashkisë Himarë ka nxjerr raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit si dhe raportin e monitorimit ku janë detajuar arsyet e mosrealizimit të shpenzimeve.*

Rekomandimi është i pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, problematikat e konstatuara, janë të ripërsëritura dhe konstatuar nga auditimet e viteve të kaluara. Zbatimi i rekomandimeve të lëna për problematikat në fjalë janë të pazbatuara. Edhe në këtë auditim janë konstatuar problematika që lidhje me procesin e inventarizimit, mbi mos kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve dhe dëmeve ekonomike të konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme, mos pasqyrim i saktë i veprimeve kontabël.

Gjithashtu Llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Himarë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 52,480,267 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Himarë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e Drejtorisë së financës nuk është marrë asnjë masë për likuidimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe19-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i'u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **5** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Himarë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, me fond limit 411,296 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 367,105 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e kritereve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga AK, si më poshtë:
- Në **1** procedura nga 5 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 66,666 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 66,344 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.
- Në **2** procedura nga 5 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 54,996 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 48,284 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Himarë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Himarë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 39, 34, 40, 41, 76, 77, 82, 92,98, dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), neni 26, 36 , 39, 45, 67,78, 82. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Himarë) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Në KLSH është administruar një ankesë e cila lidhet me problematikën e furnizimit me ujë për disa banorë të Fshatit Vranisht.
Bazuar në dokumentacionin e përfshirë në realizimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se:
- Projekt preventivi i ndërtimit të ujësjellësit të Fshatit Vranisht është hartuar nga z. K. K.(inxhinier), z. F. B. (inxhinier) dhe z. S. N. (inxhinier)
- Bazuar në termat e referencës, hartuar nga z. E. M. (qëllimi i projektit) rezulton se ujësjellësi ekzistues përbëhet nga vepra e marrjes në kuotën 432 m m.n.d, nga depo ekzistuese në kuotën 409 m m.n.d, rrjeti kryesor që lidhe veprën e marrjes me depon me tubacion me diametër 110 mm dhe rrjeti shpërndarës me dimension nga 110 mm deri 20 mm.
- Nga auditimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit (i disponueshëm në sistemin elektronik të prokurimeve dhe verifikimit në objekt), rezulton se depo e re me kapacitet 100

m^3 është ndërtuar ngjitur me atë ekzistuese, për pasojë disa banesa kanë dalë jashtë skemës së furnizimit me ujë në kundërshtim me termat e referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Nga ana e bashkisë si përfituese e projektit nuk është verifikuar dokumentacioni i projektit nëse përmbush apo jo kërkesat e përcaktuara në termat e referencës si dhe realizimi i kushteve teknike të projektit

- Kontrata e punimeve civile "*Ndërtim ujësjellës Fshati Vranisht*", është nënshkruar me datë 10.08.2021, me BOE "K. G. K. & M/S" SHPK. Nxjerrja jashtë skemës së furnizimit për disa banesa ka krijuar problematika me banorët e zonës gjatë zbatimit të kontratës.

Konkluzion:

-Projekti i zbatimit është hartuar me mangësi sa i takon përfshirjes së të gjithë fshatit në zonën e furnizimit.

- Gjatë zbatimit të kontratës janë marrë masa për ndryshimet përkatëse duke përfshirë në skemën e furnizimit banesat të cilat nuk ishin përfshirë, duke ndërtuar një depo të re me volum 12 m^3, e cila furnizohet me ngritje mekanike, duke marrë ujin nga depo 100 m^3.

Pavarësisht ndërtimit të depos së re, nuk garantohet në mënyrë të pandërprerë furnizimi me ujë të pijshëm i këtyre banesave, si për rastet kur ndërpritet energjisë elektrike, ashtu dhe në rastet e dëmtimit të pompës.

- Nga verifikimi në objekt rezulton se ujësjellësi është në funksion por përveç problematikës së mësipërme, mungon furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm për të gjithë banesat e Fshatit Vranisht.

- Problematike për këtë fshat dhe çështje e pa zgjidhur ngelet mungesa e furnizimi me ujë për vaditje dhe nga banorët përdoret uji i pijshëm për këtë qëllim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 126-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masa për shqyrtimin e projekteve për investimet, duke kërkuar respektimin e termave të referencës dhe kushtet teknike të projektimit, që në fazën e marrjes në dorëzim të tyre.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

5.2 Rekomandimi: Për banesat Fshatit Vranisht të cilat nuk lidhen drejtpërdrejtë me depon kryesore, të merren masa për vendosjen e një sistemi automatik të furnizimit me ujë të depos 12 m^2, të përbërë nga dy pompa uji dhe gjenerator me karburant, i cili furnizon me energji elektrike pompat në rast të ndërprerjes me energji elektrike të depos kryesore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhen nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1024/2 Prot, datë 28.12.2022, rezulton se:

- Në mbështetje të nenit 15, germa "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 281/27 prot., datë 13.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1024/11 datë 17.07.2023 duke respektuar afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

- Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer

përgjigje në KLSH, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuara për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
Nga **14** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **2** janë pjesërisht i zbatuar, **1** është në pazbatuar dhe **11** nuk janë zbatuar.
-Nga **3** masa për uljen e borxhit të **3** masat janë të pa zbatuara.
-Nga **4** masa për shpërblim dëmi të **4** masat janë të pa zbatuara.
-Nga **7** masa për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike të rekomanduar, të **7** masat janë të pa zbatuar.
Nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga ku niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 35%, edhe pse gjatë auditimit në terren bashkia ka vijuar me zbatueshmërinë e plotë tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 126-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces, si më poshtë.

A. Masa Organizative.

2.1.Rekomandimi: *Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim eficencën e këtij sektori të rëndësishëm për Bashkinë.*
Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi është i pazbatuar
3.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.*
Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.
Nga verifikimi rezultoi se, Nga ana e Bashkisë Himarë ka nxjerr raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit si dhe raportin e monitorimit ku janë detajuar arsyet e mosrealizimit të shpenzimeve.
Rekomandimi është i pazbatuar
5.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike.*
Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi është i pazbatuar
6.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale te aktiveve, fizike dhe kontabël.*
Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi është i pazbatuar

7.1.Rekomandime: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe debitorët e vitit 2020, të pa kontabilizuar për vlerën 103,574,000 lekë.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

8.1. Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

9.1Rekomandimi: *Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

10.1 Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

11.1.Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

12.1. Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë dokumentacionit shoqërues për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1 Rekomandimi: *Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 594/12, prot datë 08.03.2022 të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1.a Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 28,575 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti "J. T.".*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1.b Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 1,097,086 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik "B." ShPK.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1.c Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 8,789,727 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik "E. B" ShPK.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

14.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:*

1.T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

2.Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3.Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 207.65 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (14,090,740 lekë/vit, për 18 subjekte).

4.Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5.Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Paketës Fiskale.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

B. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën 287,712,121 lekë.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

2.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 8 subjekte të vlerës 8,000,000 lekë, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit,*

Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

3.1.Rekomandimi: *Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,375,850 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

C. Masa shpërblim dëmi.

1.1.Rekomandimi: *Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 951,232.26 lekë pa Tvsh nga BOE "K. I " ShPK & "I" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: "Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh", Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar .

2.1.Rekomandimi: *Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,612,310 lekë pa TVSh nga BOE "K. G. K." ShPK& "M/S" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: "Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht", Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

3.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 279,728.78 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues z. F. M..*

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

4.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 4,860,518.2 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues OE "J. I." ShPK.*

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1-1.7.Rekomandimi: *AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e*

rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.
Rekomandimi është i pazbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunksionale të bashkisë", u konstatuan problematika në lidhje me shtrimin e moketit e cila nuk ishte e vënë në mënyrë të rregullt, dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.
Problematika të konstatuara në lidhje me Bokset modulare, ku mungojnë 2 nga 4 bokset që duhet të ishin instaluar. Demi i shkaktuar përllogaritet në vlerën 2*150,000 lekë= 300,000 lekë pa TVSH.
Problematika të konstatuara në vendosjen e dritaret doppio xham, ku u konstatua që dritarja nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, si dhe është me një xham, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Bashkisë Himarë në vlerën 4m2*25,000 lekë = 100,000 lekë pa TVSH.
Problematika të konstatuara në lidhje me spotet e ndriçimit, Spot Led Horizontal, ku mungojnë 4 spote* 55,000 lekë= 220,000 lekë pa TVSH.
Problematika të konstatuara në lidhje me shtresat e pllakave të mermerit 11.68m2 – 5.3m2(që ishin shtruar)= 6.38m2*11,000 lekë/m2= 70,180 lekë pa TVSH.
Problematika të konstatuara në lidhje me veshjen e murit e cila nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, ku dallohet qartë që veshja e murit nuk është e llojit "Dru", por e një lloji tjetër materiali.
Problematika të konstatuara në ndërtimin e shkallëve të drurit, ku veshja e të cilit është jashtë përdorimit dhe nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 30-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **690,180 lekë pa TVSH** nga shoqëria " **L. K.**" ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt "Shërbimi i Pastrimit", nga ana e Bashkisë Himarë është mbajtur procesverbali i cili pasqyron dhe evidenton gjendjen aktuale të zbatimit të kontratës. Procesverbali mbahet në bazë të urdhrit nr. 180 datë 22.06.2022 "Për ndjekjen dhe kontrollin e shërbimit të pastrimit për vitin 2022" nga Kryetari i Bashkisë Himarë. Në procesverbalet e mbajtura të cilët nuk janë ditorë, nuk evidentohen sipërfaqet e pastruara (m2), vendndodhja, punonjësit etj., si dhe realizimi i

zërave të mësipërm. Vlera e paraqitur në total për OE "**A. I. C"** është në vlerën **31,298,684 lekë** pa TVSH, për O.E. **"R" ShPK**. është në vlerën **5,980,808 lekë** pa TVSH, ku në total është në vlerën **37,279,492 lekë** pa TVSH si shumë e përdorur pa Efektivitet, Eficencë dhe Ekonomicitet nga Bashkia Himarë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 30-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, gjatë hartimit të procesverbale të merret në konsideratë hartimi i tyre në mënyrë të detajuar, duke përfshirë zëra real të situacionuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, Prot. 819 datë 16.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi miratuar me Vendim të KKT Nr. 32 datë 28.12.2020 për objektin "G. C. R. 2, zona G6b, REZIDENCE BANIMI ME APARTAMENTE 2, 3, 4 dhe 5 kat me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë", në adresën Gjilekë (Dhrale), Bashkia Himarë, me zhvillues "G. C." ShPK, Subjekt Ndërtues "M. T" ShPK, projektuar nga ark. B. Sh.
Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Social (DZHES) Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.4 datë 27.01.2023 është përllogaritur me vlerën 17,722,341.40 lekë. Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del 4%*491,690,780 = 19,667,631.2 lekë.
Nga subjekti "G. C." ShPK me faturën e R. B. datë 01.02.2023 janë paguar 17,722,341.40 lekë.
Vlera e llogaritur me diferencë prej **1,945,289 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **1,945,289 lekë** me zhvillues "G. C." ShPK, Subjekt Ndërtues "M. T" ShPK, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë është dërguar njoftimi për likuidimin e vlerës 1,945,289 lekë.*
Rekomandimi është i pjesërisht i zbatuar.

2.1.Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 166, Prot.4720/2, datë 15.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 19, datë 10.06.2021 të KKT për objekt "Strukture 1-5 Kate me 1 kat nëntokë, me funksion hoteleri", ndodhur ne adresën: Rruga e Plazhit, Borsh, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqëria 'G. H. B', Shoqëria 'F. C' ShPK, Shoqëria 'A. T.'. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.265 datë 23.11.2022 është përllogaritur me vlerën 49,306,834.08 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del 4%*1,343,922,000 = 53,375,688 lekë.

Nga subjekti G. H. Borsh me faturën e O. B. datë 12.12.2022 janë paguar 49,306,834.08 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë prej **4,068,854 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **4,068,854 lekë** me zhvillues Shoqëria 'G. H. Borsh', Shoqëria 'F. C.' ShPK, Shoqëria 'A. T.'. e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e Bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë është dërguar njoftimi për likuidimin e vlerës 4,068,854 lekë*

Rekomandimi është i pjesërisht i zbatuar.

3.1.Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 26, Prot.234/1, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 18, datë 13.08.2021 të KKT për objekt "2 Banesa individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë", ndodhur në adresën: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues V. G, G. G., M. H. dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A" ShPK. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% ose 4% e vlerës së përllogaritur sipas çmimit të referencës bazuar në Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 të EKB e cila për qarkun Vlorë është 32508 lekë/m2 (përzgjidhet vlera më e lartë mes të dyjave. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.20 datë 11.03.2022 është përllogaritur me vlerën 857,007.99 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del 4%*22,581,007 = 903,240 lekë.

Po të llogaritet me çmimin e EKB kjo vlerë del 4%*32508*380 m^2=494,121,6 leke.

Nga subjekti "A" ShPK me faturën e T. B. datë 11.03.2022 janë paguar 875,007,99 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë prej **28,232 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **28,232**

lekë me zhvillues V. G., G. G, M. H. dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A" ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

4.1.Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 09, Prot.328, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 12, datë 24.11.2021 të KKT për objekt "Strukturë hotelerie 2 kate me 2 kate nëntokë, me vendndodhje në shëtitoren Qeparo, Bashkia Himarë", ndodhur ne adresën: Protopape, Fshati Qeparo Fushë në Territorin e Bashkisë Himarë, me Zhvillues S. K Person Fizik. Sipas VKB me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.257 datë 17.01.2023 është përllogaritur me vlerën 2'984'585.49 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del 4%*78,978,883.53 = 3,159,155.34 lekë. Nga subjekti S. K. me faturën e O. B. datë 18.01.2023 janë paguar 2,984,585.49 lekë. Vlera prej **174,569** lekë e llogaritur nga Bashkia Himarë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **174,569 lekë** me zhvillues S. K. Person Fizik, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandim*
Rekomandimi është i pazbatuar.

5.1.Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 127, Prot.3310/1, datë 05.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt "G. C. R 2, Zona G5, Rezidencial-vila elitare 2 kate", ndodhur ne adresën: Palasë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqëria "S. R. I" dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A. I." ShPK. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.92 datë 16.09.2022 është përllogaritur me vlerën 7,765,636.37 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del 4%*197,641,383= 7,905,655.32 lekë.

Nga subjekti Seaside Residence 1 me faturën e R. B datë 05.10.2022 janë paguar 7,765,636.37 lekë. Vlera prej **140,018 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **140,018 lekë** me zhvillues Shoqëria "S. R. I" dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A. I." ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

6.1.Gjetje nga auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 147, Prot.2648/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 16, datë 13.07.2021 të KKT për "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2 dhe 3 kat me 3 kat nëntokë dhe pishinë", ndodhur ne adresën: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B.7". Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.90 datë 16.09.2022 është përllogaritur me vlerën 7,570,581.62 lekë.

Vlera prej **29,457 lekë,** përbën të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **29,457 lekë** me zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B.7".

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë është dërguar njoftimi për likuidimin e vlerës 29,457 lekë.*
Rekomandimi është pjesërisht i zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), rezulton se:

- Ky sektor nuk disponon mjetet e nevojshme për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" neni 5.
- Inspektorët për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara në ligj, disponojnë vetëm 1 mjet lëvizës mbi ushtrimin e kontrollit në territor. Nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa që të sigurohen mjetet e nevojshme lëvizëse në përmbushje të detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV bazuar në Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, neni 4.
- 3 Inspektorët nuk e kanë arsimin përkatës në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 neni 11.

- Për periudhën objekt auditimi nga IMTV janë vendosur gjithsej 64 gjoba me vlerë 28,400,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë, ndërkohë që **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë janë në proces arkëtimi.
Gjithashtu nga ana e IMTV Bashkia Himarë nuk është bërë njoftim për Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave të subjekteve.
Veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", përkatësisht neni 16.
Nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitet në masën 2% për 30 nga momenti i moslikujdimit të gjobës nga ana e subjekteve, në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative.
- Gjatë periudhës së auditimit 01.01.2022 deri më 31.12.2022, janë nxjerrë në total 66-Vendime për prishje objektesh (kryesisht shtesa, mure rrethuese, ose ndërtime me struktura metalike dhe druri). Janë ekzekutuar nga Bashkia Himarë vetëm në 7 raste pasi nuk disponon mjetet e nevojshme për kryerjen e këtyre proceseve. Në raste të veçanta janë përdorur mjete private, pa kryer asnjë kontratë mes palëve (Bashkisë Himarë dhe personave që i disponojnë këto mjete) duke vepruar në kundërshtim me ligjin. Për këto raste janë kryer denoncime dhe ngritur padi kundrejt këtyre vendimeve. Gjithashtu nga ana e IMTV Himarë janë bërë njoftime subjekteve të ndryshme kundërvajtës për zbatimin vullnetar të urdhrave të dala nga Bashkia Himarë.
- Nga auditimi i praktikave të mbajtura nga IMTV, në lidhje me inspektimin në terren mbi kontrollet e ushtruara në subjekte të ndryshme sipas dokumentacioni teknik-ligjor, rezultoi se nuk dokumentohet plotësisht puna apo procesi i punës në rastet kur nuk konstatohen kundërvajtje apo në raste ku inspektorët dalin në terren mbi verifikimin e ndërtimeve pa leje. Nga ana e inspektorëve duhet të mbahet një regjistër apo libër ku të paraqitet procesi i punës së përditshme. Kjo në zbatim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) Nr.10296 datë 08.07.2010, neni 16, gjurma e auditimit.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

7.2.Rekomandimi: Nga ana e sektorit të Kryeinspektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

7.3 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV, për **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë.

IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit, duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatë vonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë janë dërguar njoftimet për likuidimin e vlerës.*
Rekomandimi është pjesërisht i zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e taksave e tarifave vendore në Bashkinë Himarë, rezulton se:

Plani i të ardhurave është realizuar në masën 110 %, ku nga vlera 550,547 mijë lekë e parashikuara është arkëtuar vlera prej 608,652 mijë lekë, me një diferencë në plus prej 58,105 mijë lekë. Ndikim në këtë realizim ka dhënë TNI e cila nuk është planifikuar saktë, pasi nga vlera e parashikuar prej 290,247 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 348,670 mijë lekë, duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 me vlerë 331,102 mijë lekë.

Në lidhje me detyrimet e paarkëtuara deri më 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë paraqitet në shumën 246,517,068 lekë për 3154 subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989 subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë*.

Në krahasim me fundin e vitit 2021, totali i detyrimeve të paarkëtuara është rritur për vlerën 79,284,260 lekë, nga e cila: *për subjekte fizik/juridik në vlerën 69,810,163 lekë dhe për abonentë familjarë në vlerën 9,474,097 lekë.*

Referuar të dhënave të mësipërme si dhe dokumentacionit, nga Drejtoria e Taksave Vendore për arkëtimin e tyre është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve, duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër deri në kallëzim penal, gjë e cila konstatohet dhe nga vlera e lartë e detyrimeve për subjektet fizik/juridik të cilët megjithëse ushtrojnë aktivitet nga viti në tjetrin vlera e detyrimeve vjen në rritje, duke mos marrë asnjë masë për arkëtim, ku vetëm për subjektet mbi 1 milionë lekë detyrime janë 38 subjekte me vlerë 59,637 mijë lekë sipas Aneksit 1, bashkëlidhur RPA.

Gjithashtu konstatohet dhe fakti se Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime si agjent tatimorë për arkëtimin e detyrimeve të abonentëve familjarë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të arkëtuara të cilat nuk janë xhiruar në Bashkinë Himarë, kjo për vlerën **20,024 mijë lekë**, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur RPA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 24.25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Himarë të marrë masa për:

- Ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës se detyrimeve prej 246,517,068 lekë për 3154(5594)(6643) subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989(1427)(1890) subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*
- Të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **20,024 mijë lekë**.

Në çdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura (*të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj*), të fillojë procedurat për gjobitjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Himarë është mbledhur vlera e palikujduar nga UK sha Vlorë gjatë vitit 2025. Për sa i përket vlerës së detyrimeve për abonentët nuk është marrë asnjë masë për vjeljen e tyre. Nuk është ngritur grupi i punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore.*
Rekomandimi është pjesërisht i zbatuar.

E. <u>MASA DISIPLINORE:</u>

E.1. <u>Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil</u>.
Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 58 "Llojet e masave disiplinore" dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Himarë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t'i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë.

a) **<u>Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, neni 58 germa (b) për 6 punonjës;</u>**

1. Z. L. M., në cilësinë e Drejtorit të Financës, nuk ka kryer procedurën për tërheqjen e garancisë te depozituar nga O.E. Ed K. me vlerë 1,333,333 lekë pa TVSH *"Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat"* 2022, i cili është tërhequr nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit, në kundërshtim me Nenin 30, Pika 6 E VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar".

2. Znj. B. R., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022.
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022.
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,
në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

3. Z. A. B., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

4. Z. A. G., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,
në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

5. Z. U. D., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,

në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

6. Z. S. K, në cilësinë e personit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës me objekt "Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunksionale të bashkisë", ku u konstatuan problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, në kundërshtim me zbatimet e kushteve të Kontratës së sipërmarrjes nr.3197/19 datë 07.12.2022 si dhe për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtë vlerave monetare.

b) <u>Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, neni 58 germa (c), për 3 punonjës</u>.

1. Z. F. B, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.180 prot. datë 08.11.2022 me lëndë: "Raport i Vlerësimit Teknik".

2. Zj. E. R, specialiste e praktikës Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Godine hotelerie dhe spa "Q V'**.**

3. Z. D. B, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006, si dhe për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtë vlerave monetare.

E.2. <u>Për punonjësit e larguar.</u>

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre, përkatësisht:

Z. G. S, në cilësinë e ish- drejtuesit të DPZHT
Znj. K. M, në cilësinë e ish- Drejtorit Juridik

Rekomandimi është i pazbatuar.Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë për sa i përket këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

F. <u>NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.</u>

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Himarë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe paspërfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Me ndjekjen, kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është marrë asnjë masë lidhur me masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në pazbatuar. Më qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikerkohen në menyrë të centralizuar në vijim të këtij projekt raporti.

Tabela e zbatimit të rekomandimeve paraqitet në Aneks.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me komponentët e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit u konstatua se;
Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.
Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për përformances e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Himarë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.
Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
Në Bashkinë Himarë nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.
Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion "Koordinatori i Riskut", ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.
Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).
Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur si strukturë, duke sjellë mungesën e një elementi që luan rol të rëndësishëm në funksionin e monitorimit e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, 12/d,19,20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100,

datë 25.10.2016 të MF, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MF nr.4 datë 10.01.2020, Kap. II 2.4.1 dhe 2.4.2; Kap. III, pika 3.5; Kap. IV pika 4.1.11 dhe 4.1.12; Kap. VI pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kap. VII pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-20 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimit mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Himarë, u konstatua se për periudhën 2023-2025 njësia nuk ka funksionuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Konkretisht, njësia ka funksionuar me numër të pamjaftueshëm audituesish, ndërsa audituesi i emëruar nuk ka qenë i certifikuar si "Auditues i Brendshëm". Gjithashtu, me ristrukturimin e vitit 2026 është suprimuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, duke bërë që Bashkia Himarë të mbetet pa këtë funksion të detyrueshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 10 dhe nenin 11 të ligjit nr. 114/2015, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik". Situata ka ardhur si pasojë e mosmarrjes së masave nga titullari i institucionit për ngritjen dhe funksionimin e një strukture të auditimit të brendshëm sipas kërkesave ligjore, si dhe mosplotësimit të vendeve vakante me auditues të certifikuar. Për pasojë, është cenuar funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, është ulur efektiviteti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe është rritur rreziku që mangësitë në administrimin e fondeve dhe pasurisë publike të mos identifikohen dhe trajtohen në kohë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-28, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Himarë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, duke miratuar strukturën përkatëse, plotësuar vendet vakante me auditues të certifikuar dhe siguruar që shërbimi i auditimit të brendshëm të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë të pavarur dhe efektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA-ve 2023-2025, 2024 -2026, 2025-2027 dhe buxheteve vjetore u konstatua se:

- Mungojnë dokumentet si: udhëzimi i brendshëm i nxjerrë nga titullari për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (PBA) të njësisë së vetëqeverisjes, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të bashkisë Himarë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga grupi i menaxhimit strategjik (GMS) dhe ekipet e menaxhimit të programeve (EMP) për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, nuk është hartuar Udhëzimi i Kryetarit të Bashkisë për përgatitjen e PBA-ve, si dhe dëgjesat publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim.
- Dokumentet e PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 faza e parë, për tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 dhe për fazën përfundimtare të PBA 2023-2025 e PBA 2024-2026 nuk janë miratuar me vendim nga këshilli bashkiak, si dhe nuk janë publikuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018

"Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", I ndryshuar, pikat 20,67,71,72,76,83,85, 86,87 dhe me Udhëzimin e MF nr.6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" pikat 7 dhe 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit të marrin masa që hartimi i PBA dhe buxhetit vjetor të bëhet në bashkëpunim me EMP, të cilët duhet hartojnë dhe të paraqesin kërkesat buxhetore me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të GMS, si dhe kryerjen e konsultimit publik nëpërmjet organizimit të dëgjesave publike me palët e interesit. Pas përgatitjes së PBA në çdo fazë në afatin e miratuar të merren masa që të paraqiten në këshillin bashkiak dhe të merret miratimi i tij, në përfundim të bëhet publikimi i dokumentit të plotë PBA dhe buxhetit vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për periudhën 2023-2024-2025 u konstatuan mangësi në raportimin e realizimit të buxhetit dhe në evidentimin e detyrimeve të prapambetura. Konkretisht, treguesit e realizimit të buxhetit të paraqitur në raportet vjetore të monitorimit nuk rakordohen me të dhënat e Thesarit, ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 nuk janë hartuar raportet periodike 4-mujore dhe raportet vjetore nuk rezulton të jenë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.

Gjithashtu, detyrimet e prapambetura nuk janë evidentuar dhe raportuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, pasi vlerat e raportuara nuk përputhen me të dhënat e akt-rakordimit me Thesarin dhe nuk mbështeten në mënyrë të mjaftueshme me analizën e faturave të papaguara. Për vitin 2025, ndërsa nga akt-rakordimi me Thesarin detyrimet e prapambetura rezultojnë në shumën 48,492,482 lekë, në raportimet e Bashkisë paraqiten në vlerë të ndryshme, ndërkohë që në pasqyrat financiare ato rezultojnë të pasqyruara në vlerën 0 lekë. Këto mospërputhje kanë ndikuar në saktësinë e raportimit të gjendjes financiare të Bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 40/h, 48/1, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91, me Udhëzimin e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit të marrë masa për përgatitjen e raporteve të monitorimit të buxhetit të plota dhe të sakta, sipas formateve të miratuara, si dhe për paraqitjen e tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Këshillit Bashkiak, brenda afateve ligjore. Gjithashtu, të sigurojë evidentimin, rakordimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve të prapambetura me të dhënat e Thesarit, ndjekjen e vazhdueshme të likuidimit të tyre dhe përllogaritjen e saktë të peshës së stokut të detyrimeve ndaj shpenzimeve faktike, me qëllim monitorimin në vijimësi të situatës financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit, njoftimit të detyrimeve dhe arkëtimeve për tatimpaguesit familjarë rezultoi se:

Nuk është dokumentuar me procesverbal niveli i detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifat vendore sipas kategorive, në datën 31.12.2025;

Nuk është kryer dokumentimi, protokollimi dhe arkivimi i kopjes së printuar dhe elektronike të regjistrit vjetor të detyrimeve, në momentin e mbylljes së vitit ushtrimor dhe para hapjes së regjistrit të vitit pasardhës;
Procesi i popullimit të regjistrit elektronik dhe përpunimi i të dhënave kryhet nga i njëjti personel, pa ndarje funksionesh dhe kontrolle të brendshme të mjaftueshme. Mungojnë evidenca të monitorimit të procesit të përpunimit të dhënave dhe raportimit të tyre në formë elektronike dhe shkresore drejt drejtuesve dhe titullarit.
Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenin 5/iv, të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-48 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë të marrë masa për formalizimin e procedurave për mbylljen, dokumentimin dhe arkivimin e regjistrit vjetor të tatimpaguesve; sigurimin e ndarjes së detyrave midis personave që kryejnë popullimin e regjistrit dhe atyre që përgatisin raportet dhe njoftimet e detyrimeve; vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të procesit të administrimit të regjistrit elektronik të tatimpaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore rezultoi se:
- Nuk rezultojnë rakordime të dokumentuara periodike dhe vjetore midis Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë dhe Drejtorisë së Financës e Buxhetit, por vetëm komunikim shkresor mbi nivelin e realizimit të ardhurave. Këto veprime janë jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", , Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-47 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në koordinim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë të marrin masa për kryerjen e rakordimeve periodike e vjetore të detyrueshme dhe të dokumentuara midis të dhënave të regjistrit elektronik dhe kontabilitetit; formalizimin e procedurave të gjurmimit dhe dokumentimit të dhënave financiare, si dhe minimizimin e përpunimit manual të dhënave dhe përmirësimin e integrimit të sistemeve të raportimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2025, ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Drejtorisë Vendore të ASHK-së Vlorë nuk janë kryer akt-rakordime periodike për evidentimin dhe verifikimin e të ardhurave që arkëtohen për llogari të Bashkisë. Si pasojë, Bashkia nuk ka disponuar një proces të dokumentuar dhe periodik për krahasimin e të dhënave të ASHK-së me të ardhurat e evidentuara dhe të arkëtuara në sistemin e saj financiar.
Kjo situatë dobëson kontrollet e brendshme mbi administrimin dhe monitorimin e të ardhurave vendore dhe krijon risk që të ardhurat që i takojnë Bashkisë të mos identifikohen, regjistrohen dhe arkëtohen në mënyrë të plotë dhe në kohë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar neni 117; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; Ligji nr. 10296,

datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 30-48 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë të marrin masat për të kryer rakordimet periodike me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave; evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës dhe të fillojë procedurat për aplikimin e gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë, sipas legjislacioni mbi procedurat tatimore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së mbajtjes së kontabilitetit rezulton se për veprimet ekonomike nëpërmjet bankës kontabilizimi është bërë në mënyrë të pa plotë, vetëm sipas natyrës së shpenzimeve dhe jo sipas destinacionit. Mungojnë librat ditarë për veprimet me magazinën, për blerjet e lëvizjet e aktiveve afatgjata dhe libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II pika 2.2 nënpikat 15-23, Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 52-68 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur të gjitha fazat, që nga mbajtja e librave-ditarë kontabël kronologjik të transaksioneve dhe veprimeve ekonomike, deri në pozicionin përfundimtar të tyre në llogari.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së flukseve monetare rezulton se shumat në llogaritë sintetikë dhe anilitikë nuk janë të sakta, pasi janë keq klasifikuar, pavarësisht se seksioni "Teprica e likuiditeteve" si në çelje në shumën 1,522,178,282 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2025 në shumën 3,623,137,621 lekë është sipas aktrakordimit me thesarin. Kjo ka ndodhur sepse veprimet në debi dhe në kredi të llogarisë 520"Disponibilitete në Thesar" sa i përket shumave të transaksioneve nuk janë të sakta, kështu:

a. Tek rubrika I "Veprimtaritë e shfrytëzimit" seksioni 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" paraqitet në shumën 142,211,624 lekë, kur duhet të ishte 197,010,542 lekë sipas aktrakordimit me thesarin. Po kështu kjo shumë nuk rakordon me gjendjen e llogarive analitike 7200-7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)" në pasqyrën e performancës që paraqitet në shumën 304,161,341 lekë.

- ✓ Seksioni 2 "Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor" paraqitet në shumën 3,065,758,069 lekë, ku përfshihet gjendja e llogarisë analitike "Të hyra nga tatimet" paraqitet në shumën 3,037,612,123 lekë, sipas pasqyrës së përformances llog.70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet" paraqiten në shumën 2,788,598,682 lekë. Ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin totali i të ardhurave të arkëtuara është në shumën 2,945,875,792 lekë
- ✓ Seksioni 3 "Pagesa për detyrime e shpenzime korente" paraqitet në vlerën 528,074,914 lekë, së cilës duke i zbritur pagesat për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 507,663,542 lekë, ndërkohë sipas aktrakordimit me thesarin shpenzimet

faktike për pagesat për detyrimet e vitit ushtrimor dhe vitet e kaluara janë në vlerën 544,406,691 lekë.

b. Tek rubrika e II " Veprimtaritë e investimeve" e cila paraqitet në mënyrë të gabuar në vlerën -578,935,440 lekë, kur duhet të ishte në vlerën +51,162,377 lekë, sepse është plotësuar vetëm llogaria analitike "Pagesa për detyrimet e investimeve të vitit ushtrimor" e cila paraqitet në vlerën 578,935,440 lekë, ndërkohë sipas aktrakordimin me thesarin për shpenzimet është në vlerën -542,182,392 lekë, pra me një diferencë prej 36,753,048 lekë. Ndërsa llogaria analitike "Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale" nuk është plotësuar dhe paraqitet në vlerën 0 lekë, kur duhet të ishte në vlerën +593,344,769 lekë sipas aktrakordimit me thesarin.

c. Tek rubrika III "Transfertë të tjera" paraqitet në shumën 0 lekë, pasi llogaritë analitike paraqiten të pa plotësuara si: "Derdhje e Transferime të Ardhurave ne Buxhet" "Transferime në buxhet të fondeve të pa përdorura", "Lëvizje të brendshme e transferta të tjera", duke mos u përputhur me aktrakordimin me thesarin.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kap. 3.5 i ndryshuar me UMF nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 24. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 52-68. të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të marrë masa që në hartimin e pasqyrës të flukseve monetare të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të paraqesë qartë e saktë gjendjet dhe analizat e rubrikave Veprimtaritë e shfrytëzimit" , " Veprimtaritë e investimeve" dhe "Transferta të tjera", duke i rakorduar me Thesarin dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

Deri me datë 31.03.2027

10. Gjetje nga auditimi: Teprica e *llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 287,712,000 lekë, vlerë e cila nuk është e saktë dhe e besueshme, pasi edhe në fund të vitit 2024 paraqitet në të njëjtën vlerë. Kjo vlerë nuk dihet se çfarë përfaqëson, pasi mungon analiza e saj sipas kategorive të debitorëve, duke sjellë mos pasqyrimin e plotë të drejtave të konstatuara në pasqyrat financiare. Referuar të dhënave të DTTV gjatë vitit 2025 është krijuar një debi prej 14,864,937 lekë nëse është reale, vetëm nga taksapaguesit familjarë për taksa e tarifa vendore (12,028,288lekë), individë për taksën në infrastrukturë për legalizimet (832,649 lekë) dhe subjektet për tarifën vjetore të autorizimit për lejimin e aktivitetit për tregtim karburantesh (2,000,000 lekë), ndërsa për debitorët taksapagues të biznesit nuk ka të dhëna. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. III, kap.3.1, pika 32, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve" paragrafi "Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve" fq 28-30.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 52-60. të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të shqyrtojë dokumentacionin financiar në vite për analizimin e shumave të paraqitura në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që të kontabilizojë vlerat debitorë nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të drejtave për arkëtim të debitorëve në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogaritë e tjera të lidhura me to.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve afatgjata jo materiale dhe materiale të praqitura në formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata", rezultoi se në gjendjet e llogarive (kosto historike) të këtyre grup aktivesh janë të pa analizuara, nuk ka një inventar kontabël dhe mungon inventari fizik për to, si për: gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 182,687,308 lekë, gjendjen e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 22,620,865,178 lekë; gjendjen e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,528,215,355 lekë; gjendjen e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 915,522,382 lekë; gjendjen e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"* në vlerën 23,747,353 lekë; gjendjen e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 44,402,639 lekë; gjendjen e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 21,636,289 lekë. Kjo situatë ndikon në besueshmërinë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit të aktiveve materiale qarkulluese dhe AAGJ rezulton se ka dalë urdhri i titullarit nr.639, datë 21.10.2025 "Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve në Bashkinë Himarë për vitin 2025", i cili përcakton kryerjen e procesit të inventarizimit për të gjithë aktivet dhe përfundimin e inventarit me datë 29.12.2025. Në fakt procesi i inventarizimit ka filluar dhe nuk është mbyllur akoma në të gjitha objektet e bashkisë dhe përfshin vetëm inventarizimin e aktiveve të llogarive 31 "Materiale" në shumën 3,883,079 lekë, llog.32 "Inventar i imët" në shumën 11,117,197 lekë dhe llog.218 "Inventar ekonomik", duke u shoqëruar me mungesa dhe mangësi në dokumentacion.
Këto veprime janë në kundërshtim UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar Kreu III, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pikat 73-106, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 50-60, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit fizik dhe saktësimin e inventarit kontabël për të gjitha aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale, Në përfundim të procesit, të rakordohen rezultatet e inventarizimit fizik me të dhënat e kontabilitetit, duke sistemuar diferencat, si dhe të kryhen regjistrimet përkatëse kontabël, duke siguruar që vlera, përbërja dhe gjendja e aktiveve të pasqyrohen saktë në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare.

Deri më datë 31.12.2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi se tepricat e llogarive 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhur me to"* dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në shumën 0 lekë. Sipas raportimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave për detyrimet e prapambetura për vitin 2025 për gjithë njësitë shpenzuese rezulton se Bashkia Himarë ka detyrime të prapambetura deri në fund të dhjetorit të vitit 2025 në shumën 2,000,000 lekë për fatura të palikujduara për shpenzime për investime. Ndërsa referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit sipas sistemit "accrual" detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në fund të vitit 2025 rezultojnë në shumën 48,492,482 lekë. Pra mungon një evidentim i saktë dhe i plotë i detajuar i detyrimeve që ka bashkia ndaj të tretëve në fund të periudhës ushtrimore. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i

ndryshuar, Kreu II pika 8, 15/a,b,c,18/a, b, Kreu III, pika 42, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, pika 3.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 52-58, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të kryejë veprimet në kontabilitet për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë detyrimeve ndaj të tretëve në llogaritë e klasës 4, duke kontabilizuar të gjitha faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh të papaguara, me qëllim që pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor të japin një informacion të saktë e të besueshëm në lidhje me detyrimet afatshkurtra.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në pasqyrën e pozicionit financiar rezulton se për disa llogari mungon informacioni kontabël dhe dokumentacioni mbështetës për:

- tepricën e llogarisë sintetike 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 2,399,340,108 lekë, vlerë për të cilën mungon analiza kontabël. Kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar ose të pa marra në dorëzim.
- tepricën e llogarisë *26 " Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 231,278,350 lekë, vlerë e cila është trashëguar nga vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka informacion se çfarë investimi kapital është kryer.
- tepricën e llogarisë 109 *"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata",* si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 23,230,799,929 lekë, vlerë e cila është e trashëguar me vite dhe mungon informacioni për të. Llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i AAGJ" preket nga procesi i rivlerësimit që lidhet me daljen e një VKM për rivlerësimin e Aktiveve afatgjata, materiale dhe jo materiale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 52-61, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit të Buxhetit të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të dhënave për llogaritë 230-231*"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale", 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* dhe 109 *"Rezerva nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata"* për nxjerrjen e të dhënave për investimet dhe rivlerësimin e aktiveve mbi ç'bazë janë kryer për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Deri më datë 31.03.2027

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës në lidhje me:

- ✓ Analizën e të ardhurave konstatohet se,

- Gjendja e llogarisë sintetike *70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"* paraqitet për vitin 2025 në vlerën 2,788,598,682 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin të ardhurat nga taksat dhe tatimet janë në shumën 2,945,875,792 lekë, pra me një deviacion prej 157,277,110 lekë. Nuk janë plotësuar llogaritë analitike të ardhurave tatimore dhe jo tatimore.
- Gjendja e llogarive analitike 7200-7201 *"Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore dhe vendore)"* në pasqyrën e performancës paraqitet në më mënyrë të gabuar në shumën 304,161,341 lekë, pasi sipas aktrakordimit me thesarin është 197,010,542 lekë.
- Gjendja e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" në shumën 1,456,989,769 lekë që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës të pasqyruar një herë në atë vit dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.

- ✓ Analizën e shpenzimeve konstatohet se,

- Teprica e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025, paraqitet në shumën 212,804,197 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 210,947,910 lekë, duke u mbivlerësuar për shumën 1,856,287 lekë.
- Teprica e llogarisë *601 'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025, paraqitet në shumën 35,161,047 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 33,334,597 lekë, duke u mbivlerësuar për shumën 1,826,450 lekë.
- Teprica e llogarisë *602"Blerje mallra e shërbime",* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 175,366,648 lekë, por nga përllogaritja rezulton në shumën 226,560,887 lekë, pra është paraqitur 51,194,239 lekë më pak.
- Teprica e llogarisë së fondeve *604 "Transferime korente te brendshme"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 17,783,945 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 5,816,345 lekë, pra është paraqitur 11,967,600 lekë më shumë.
- Seksioni "Shpenzime të tjera" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në shumën 517,423,198 lekë, vlerë për të cilën nuk ka analizë dhe nuk ka informacion nga çfarë ka rezultuar kjo vlerë. Në këtë seksion evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë analoge në pasqyrën e flukseve monetare etj.

Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025, rrjedhimisht pozicionin financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, duke mos dhënë siguri edhe mbi tepricat e transaksioneve mbi të cilat është përgatitur pasqyra e flukseve apo pasqyra e pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Aneksi 1, pika 3, faqe 48-51. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-60 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

14.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të sigurojë që të bëhet kontabilizimi i saktë i veprimeve me fondet dhe transaksioneve financiare në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e përformances, duke i rakorduar me Thesarin dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

Deri më datë 31.03.2027

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 874/14 prot, datë 17.05.2024, rezulton se:
- Në mbështetje të nenit 15, germa "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 315/26 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 874/15, datë 09.05.2024 duke respektuar afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.
- Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë Shtetit", nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer përgjigje në KLSH, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuara për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Nga **21** masa organizative të rekomanduara gjithsej nga të cilat **21** janë pazbatuar;
-Nga **5** masa për shpërblim dëmi, të **5** masat janë të pa zbatuara;
-Nga **2** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë në të pazbatuara;
-Nga **13** masa të ardhura të munguara nga të cilat **6** pjesërisht të zbatuara dhe **7** të pazbatuara;
-Nga **11** masa disiplinore, të **11** janë të pazbatura.

Nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga ku niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 0%. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 68-87 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri- kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces, si më poshtë.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe drejtoritë e tjera të Bashkisë Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i'u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Himarë) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masa për shqyrtimin e projekteve për investimet, duke kërkuar respektimin e termave të referencës dhe kushtet teknike të projektimit, që në fazën e marrjes në dorëzim të tyre.

5.2 Rekomandimi: Për banesat Fshatit Vranisht të cilat nuk lidhen drejtpërdrejtë me depon kryesore, të merren masa për vendosjen e një sistemi automatik të furnizimit me ujë të depos 12 m^2, të përbërë nga dy pompa uji dhe gjenerator me karburant, i cili furnizon me energji elektrike pompat në rast të ndërprerjes me energji elektrike të depos kryesore.

2.1.Rekomandimi: *Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim eficencën e këtij sektori të rëndësishëm për Bashkinë.*

3.1.Rekomandimi: *Bashkia Himarë të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.*

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

5.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike.*

6.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale te aktiveve, fizike dhe kontabël.*

7.1.Rekomandime: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe debitorët e vitit 2020, të pa kontabilizuar për vlerën 103,574,000 lekë.*

8.1. Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.*

9.1Rekomandimi: *Drejtoria e Integrimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.*

10.1 Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.*

11.1.Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.*

12.1. Rekomandimi: *Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit shoqërues për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.*

13.1 Rekomandimi: *Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 594/12, prot datë 08.03.2022 të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.*

13.1.a Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 28,575 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti "J. T".*

13.1.b Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat*

administrative për arkëtimin e vlerës 1,097,086 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik "B.7" ShPK.

13.1.c Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 8,789,727 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik "E. B" ShPK.*

14.1.cRekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:*

1.T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

2.Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3.Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 207.65 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (14,090,740 lekë/vit, për 18 subjekte).

4.Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5.Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Paketës Fiskale.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **690,180 lekë pa TVSH** nga shoqëria " **L. K.**" ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

1.1.a.Rekomandimi: *Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 951,232.26 lekë pa Tvsh nga BOE "K I " ShPK & "I" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: "Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh", Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

2.1.a.Rekomandimi: *Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,612,310 lekë pa TVSh nga BOE "K. G. K." ShPK& "M/S" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: "Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht", Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

3.1.a.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 279,728.78 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues z. F. M.*

4.1.a.Rekomandimi: *Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë*

procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 4,860,518.2 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues OE "J. I" ShPK.

C. <u>MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE</u>.

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Bashkia Himarë, personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, gjatë hartimit të procesverbale të merret në konsideratë hartimi i tyre në mënyrë të detajuar, duke përfshirë zëra real të situacionuar.

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **1,945,289 lekë** me zhvillues "G. C." ShPK, Subjekt Ndërtues "M.T" ShPK**,** e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

<u>2.1 Rekomandimi</u>: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **4,068,854 lekë** me zhvillues Shoqëria 'G. H. B', Shoqëria 'F. C.' ShPK, Shoqëria 'A. T'. e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e Bashkisë Himarë.

<u>3.1 Rekomandimi</u>: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **28,232 lekë** me zhvillues V. G, G. G., M. H. dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A" ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

<u>4.1 Rekomandimi</u>: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **174,569 lekë** me zhvillues S. K. Person Fizik, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

<u>5.1 Rekomandimi</u>: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **140,018 lekë** me zhvillues Shoqëria "S. R I" dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A. I." ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

<u>6.1 Rekomandimi</u>: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **29,457 lekë** me zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B.7".

<u>7.1. Rekomandimi:</u> Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

7.2.Rekomandimi: Nga ana e sektorit të Kryeinspektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

7.3 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV, për **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë. IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit, duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatë vonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Himarë të marrë masa për:

- Ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës se detyrimeve prej 246,517,068 lekë për 3154(5594)(6643) subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989(1427)(1890) subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*
- Të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave

1.1-1.7.Rekomandimi: *AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.*

D. MASA PÉR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NÉ MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **1,945,289 lekë** me zhvillues "G. C." ShPK, Subjekt Ndërtues "M.I" ShPK**,** e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **4,068,854 lekë** me zhvillues Shoqëria 'G. H. B.', Shoqëria 'F. C' ShPK, Shoqëria 'A. T'. e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e Bashkisë Himarë.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **28,232 lekë** me zhvillues V. G, G.G, M. H dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A" ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **174,569 lekë** me zhvillues S. K. Person Fizik, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **140,018 lekë** me zhvillues Shoqëria "S.R.I" dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A.I" ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **29,457 lekë** me zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B.7".

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

7.2.Rekomandimi: Nga ana e sektorit të Kryeinspektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

7.3 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV, për **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë. IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit, duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatë vonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Himarë të marrë masa për:

- Ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës se detyrimeve prej 246,517,068 lekë për 3154(5594)(6643) subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989(1427)(1890) subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*
- Të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **20,024 mijë lekë**.

Në çdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura (*të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj*), të fillojë procedurat për gjobitjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave

E. MASA DISIPLINORE:

a.Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, neni 58 germa (b) për 6 punonjës;

1. Z. L. M, në cilësinë e Drejtorit të Financës, nuk ka kryer procedurën për tërheqjen e garancisë te depozituar nga O.E. Ed Konstruksion me vlerë 1,333,333 lekë pa TVSH

"Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat" 2022, i cili është tërhequr nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit, në kundërshtim me Nenin 30, Pika 6 E VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar".

2. Znj. B. R, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022.
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022.
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,
në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

3. Z. A. B, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

4. Z. A. G, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,
në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

5. Z. U. D, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:
"Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç" për vitin 2022
"Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë" për vitin 2022,
në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

6. Z. S. K, në cilësinë e personit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës me objekt "Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunksionale të bashkisë", ku u konstatuan problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, në kundërshtim me zbatimet e kushteve të Kontratës së sipërmarrjes nr.3197/19 datë 07.12.2022 si dhe për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtë të vlerave monetare.

b.Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, neni 58 germa (c), për 3 punonjës.

1. Z. F. B., për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.180 prot. datë 08.11.2022 me lëndë: "Raport i Vlerësimit Teknik".

2. Zj. E. R., specialiste e praktikës Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Godine hotelerie dhe spa "Queen Vasilika'**.**

3. Z. D. B., në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh" për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006, si dhe për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtë të vlerave monetare.

E.2. Për punonjësit e larguar.

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre, përkatësisht:

Z. G. S., në cilësinë e ish- drejtuesit të DPZHT

Znj. K. M, në cilësinë e ish- Drejtorit Juridik

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se detyrimet për taksa dhe tarifa vendore, në fund të vitit 2025 janë në vlerën 314,808,552 lekë.
-Detyrimet që subjektet fizike/juridike kanë ndaj Bashkisë Himarë për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 janë në vlerën 171,283,112 lekë.
Nga të cilat krijuar:
-Detyrime nga taksapaguesit familjarë për taksa dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 janë në vlerën 80,900,386 lekë.
-Detyrimet të krijuara gjatë vitit 2025 për taksën e infrastrukturës nga legalizimet janë në vlera 1,300,985 lekë.
-Detyrimet nga subjektet private për tarifën e autorizimit për leje të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve krijuar gjatë vitit 2025 janë në vlerë 1,100,000 lekë.
Debitorët nuk janë evidentuar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018,*"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar.
Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqe 30-45 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e borxhit tatimor në vlerën 314,808,552 lekë. Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit, të bëjë të mundur kontabilizimin e detyrimeve nga taksat e tarifat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE
Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "Për

vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Himarë,** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT